

# KOLE JAKOVA

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

7 JH -

## DRAME

## WYBET

## E SHTETES

8114-3  
721.

KOLË JAKOVA

# LULET E SHEGËS

*dramë në dy pjesë*



19403

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

Tirazhi 2500 kopje

Format 70x100/32

Stazh: 2204-72

---

KOMBINATI POLIGRAFIK — Shtypshkronja e Re  
Tiranë, 1976



## PERSONAZHET:

LAJA — kryetare e këshillit, 35-vjeçe.

MANI — vëllai i Lajes, 24-vjeç.

SELIMI — bujk, 45-vjeç.

HAVAJA — gruaja e Selimit, 40-vjeçe.

LULJA — e bija e Selimit, 19-vjeçe.

BEQIR AGA — tregtar i madh, 55-vjeç.

ZENELI — kujdestar i pasurisë së Beqirit, 50-vjeç.

BUDJA — gruaja e Zenelit, 45-vjeçe.

HALILI — kriminel, 35-vjeç.

Katër-pesë partizanë dhe të rinj fshatarë.

Ngjarja zhvillohet në qershor të dyzet e pesës në një fshat shumë afër Shkodrës.



## PJESA E PARË

### Tabloja e parë

*Skena paraqet një vend të qetë, të errësuar nga blerimi. Duken shegët që kanë çelur lule të kuqe, të ndezura. Në sfond duken larg ara e fusha. Në të majtë duket një pus i madh i shtëpisë verore të Beqir agës. Është pus i punuar bukur dhe i mbuluar me tendë rrushi. Afër shegëve Mani ka hapur një gropë ku do të vihet një gur si shenjë se aty është vrarë një njeri. Lulja vjen me një ibrik uji në dorë.*

MANI — Ja, edhe kjo punë u krye.

LULJA — U lodhe?

MANI — Se mos bëra ndonjë gjë të madhe.

LULJA — Tani unë do të iki.

MANI — Ku do të shkosh?

LULJA — Më ka ngelë edhe lagjja Bregej pa lajmëruar. Gratë kanë mbledhje të dielën. Vijnë dy shoqe nga Shkodra.

MANI — Ç'thonë gratë, do të mblidhen?

LULJA — Do të mblidhen, thua? Ato mezi që po presin. E di si më tha Zenepja e Dushit kur e lajmërova? Bëjeni mbledhjen në oborr të pallatit të Beqir agës dhe qofsha qyqe po s'e hoqa çarçafin e po nuk kërceva valle që të tundet ky vend!

MANI — E gjora Zenepe! Sa keq ia ka punuar Beqir  
aga. E kujt nuk ia ka punuar keq ai katil? (*Lulja  
i jep ujë me ibrik*) Laja brenda është?

LULJA — Po.

MANI — Ulu, Lule, rri këtu pranë meje.

LULJA — Jo, Man, se na shikon Laja e është turp.

MANI — E ku do të na shikojë Laja prej andej? Pas-  
taj, nga Laja mos ki as frikë as turp. Asaj i vjen  
mirë kur na shikon bashkë. Shih sa bukur është  
këtu, gjithë blerim. Të pëlqejnë lulet e shegës?

LULJA — Shumë.

MANI — Edhe Sulës së shkretë i pëlqenin. Ai i quante  
lulet e revolucionit. Unë i dua këto shegë se kanë  
moshën time. I ka mbjellë baba atë vit që lamë  
Shkodrën e erdhën këtu në Vulkaj, në shtëpinë ve-  
rore të Beqir agës. E mori Beqiri si kopshtar për  
bahçen.

LULJA — Latë atë alamet Shkodre e erdhët këtu.

MANI — E si të bënte baba i shkretë! Kopshtin e shtë-  
pisë ia mori Beqiri se s'kishte të paguante faizin.  
U detyrua nga halli. Prapë nuk jemi larg. Ja ku  
është Shkodra, dy hapa. Atë vit linda edhe unë.  
Kurse nëna vdiq gjatë lindjes. Laja thotë se baba  
u bë si i çmendur. E kishte dashur shumë nënën.  
Të nesërmen që varrosi nënën erdhi këtu e mbo-  
lli këto shegë.

LULJA — E pse Shegë?

MANI — Sepse nga të gjitha pemët që rriste baba, she-  
gët ajo i pëlqente më tepër.

LULJA — I gjori Xhemal, e vranë pikërisht te këto  
shegë.

MANI — Edhe atë ditë shegët kishin çelur si sot. U  
mbush një vit. Pa ulu, ç'më rri në këmbë si nu-  
set e motit.



LULJA — Po na shohin, o Man. (*Ulet*). Mandej, sikur nuk vete. Ju përgatiteni të përkujtoni babën, kurse ti...

MANI — Çfarë unë?

LULJA — Kërkon të të rri afër.

MANI — Ç'të keqe ka? Sot Laja do të të kërkojë te Selimi për mua.

LULJA — Edhe ajo e gjeti ditën.

MANI — E bën nga dëshira që të shohë një dasmë në shtëpinë tonë. Nuk ka faj. Në prag të fitores ajo ngeli vetëm me mua. Unë atë e kam edhe motër edhe nënë. Nënë s'e njoha. Laja më rriti. Baba nuk pranoi kurrsesi të martohet. Atëherë as ajo nuk pranoi martesë dhe zuri këmbën e nënës. Martoi dy motrat që ishin pas saj dhe na rriti mua e Sulën, që ishim më të vegjël. Ti nuk e beson sa të do Laja ty. Po aq sa të dua dhe unë. Çfarë ke?

LULJA — Nuk e di çfarë do të thotë baba. Ai ka hall të martojë Rakipin dhe i vjen koka vërdallë. Sa mirë, thotë, që e morën ushtar se s'kisha me çfarë ta martoja. E po sikur të mos pranojë baba?

MANI — Të grabis.

LULJA — Shumë mirë. Ikim në Shkodër.

MANI — Si, pranon t'i sjellësh shpinën këtij vendi?

LULJA — (*Mendohet*) Jo, nuk e braktis dot Vulkajn. Nuk ndahem dot nga ky vend. Megjithatë Shkodra më pëlqen. Atje njerëzit sikur qeshin e janë gjithnjë të gëzuar.

MANI — Ashtu është, Lule. Jemi kënaqur të dielën kur vajtëm në demonstratë për të kërkuar njohjen e Qeverisë. Sikur nuk kishte ngelur njeri nëpër shtëpia, kaq shumë ishim. Si u sollëm njëherë duke thirrur e duke kënduar vëmë në Fushë-Qelë dhe aty ia nisëm valles. Kur vërejmë një punëtor që kishte



hipur në një shtyllë telefoni dhe thërriste me sa zë kishte: «Kërceni, kërceni vëllezër se u bëmë sa mali i Taraboshit!». Të gjithë qeshëm dhe duartrokitëm.

LULJA — Sa bukur e paska thënë.

MANI — Ashtu u bëmë me të vërtetë. Ja, shikoje pallatin e Beqir agës. Ai do të shtetëzohet. E kush do ta gëzojë? Ne bujqit. Do kemi tokë, shtëpi, bagëti.

LULJA — Sa bukur do të jetë.

MANI — Vendi do të zbukurohet. Nuk do të ketë më agallarë, as borxhe. Kriminelët do t'i shfarosim siç i shfarosëm ata trembëdhjetë vetët. Do të dëgjosh prapë këto net.

LULJA — Çfarë do të ndodhë këto net?

MANI — Qepe, është sekret. Tani rri e dëgjo disa udhëzime që na i dhanë në mbledhje, në Shkodër.

LULJA — Çfarë mbledhje?

MANI — Mbledhje partie i thonë, po ti mos i thuaj njeriu. Po të tregoj një të fshehtë. Si unë, si Laja jemi në Partinë Komuniste.

LULJA — Sikur s'e di unë që jeni komunistë.

MANI — Nejse, mos e ço më gjatë. Dëgjo, jemi ca ngushtë për bukë. Kështu na thanë në Shkodër.

LULJA — E mandej?

MANI — Tregëtarët e kanë fshehur drithin. Një depo të madhe e zbuluan në Tophanë. Kam dyshim se ajo kulla e barit mos ka drithë brenda. Edhe Laja kështu mendon. Në kohë të gjermanëve nuk pushonin makinat duke shkarkuar atje. Kështu thonë fshatarët. Ç'djall shkarkonin?

LULJA — Shkarkonin dengje bari. Kështu i ka thënë Zenel Dani babës.

MANI — Se mos tregon Zeneli!... Po kur e ka marrë yt atë në dorëzim kullën e barit?

LULJA — Ka tre muaj.

MANI — Ai s'ka vërejtë gjë?

LULJA — E çfarë do të vërente? Atje janë treqind denge bar.

MANI — Sidoqoftë ai vend duhet kontrolluar. Laja ka vënë ca njerëz që ta kenë kujdes, sidomos natën. Këtë mos ia thuaj tyt eti se është ca i leshtë ai. Nuk ia pret më tepër. E sa për barin do të vijë ushtria ta marrë se i duhet për kafshë. Në mbledhje na thanë se tregtarët kanë fshehur mallin e arin. Mirëpo vendi është shkatërruar nga lufta. Nuk është çudi që Beqir aga të ketë fshehur diçka ose në kullë të barit ose në pallat. Pra i mblidh edhe një herë ato të rejat e u thuaj t'i bëjnë sytë katër. Duhet parë sidomos lëvizjet e Zenel Danit dhe të Budes. Të shikojnë mirë çfarë njerëzish hyjnë e dalin në pallat.

LULJA — Do ta kem në kujdes. Shoqet më pyesin gjithnjë kur do të ndahen tokat.

MANI — Shpejt do të dalë ligji, u thuaj. As dy muaj nuk shkojnë.

LULJA — Po a do t'i marrim tokat që punojmë?

MANI — Çudi e madhe, gjithnjë këtë pyetje bëjnë kudo. Po tokat kush do t'i ndajë? Mos do të vijë të na i ndajë Beqir aga me Zenelin? Laja do të jetë në krye të këtyre punëve bashkë me komunistët dhe me bujqit e varfër.

*(Hyn Laja. Lulja menjëherë largohet nga Mani).*

LAJA — U turpërua vajza. Çfarë po të përralliste karafili?

LULJA — Po bisedonim punë Lëvizjeje.



- LAJA — Kujdes veç, o Lule, se këtij i lëvizin edhe duart e pastaj ec e merru vesh me Selim Myrton.
- MANI — Jo, moj Laje, se s'ka ndonjë gjë të keqe. Ajo mollë e unë ftua. Ajo më do e unë e dua!
- LAJA — Pusho, more pallavesh. Kur na u bëre edhe ti kaq këndes? E turpërove vajzën. (*Shikon gropën*). Mirë. Tani ejani të shkojmë në shtëpi se po ju gjen Selimi bashkë e bën namin. (*Lules*) Si duket Selimi? Si e ka syrin nga ajo anë?
- LULJA — Si të them, o Laje. Rri i heshtur si gjithnjë.
- LAJA — I foli gjë Havaja?
- LULJA — Jo. Kam frikë, thotë, se e prish fare.
- LAJA — Nejse, do t'i flas unë sot. Ia mban akoma ca zinë Beqir agës. E ka ca kokën me nyje. Do punë për t'u gdhendë. Po do t'ia mbushim mendjen. Të foli gjë Mani për tregtarët, për kullën e barit, për pallatin?
- LULJA — Më foli.
- LAJA — Ju të rejat mund të bëni shumë punë. Ti duhet të shkosh me tët atë në kullë e të vëresh si domos për drithë. Po jo vetëm për drithë...
- LULJA — Do të vete patjetër. Po vajzat kërkojnë të vish ti e t'u flasësh.
- LAJA — Kur mund t'i mbledhësh?
- LULJA — Kur të jesh ti e lirë.
- LAJA — Sot kam mbledhjen e këshillit, mbledhjen e agjitorëve... Ejani sonte në shtëpinë time. Nuk është Mani. Mirë?
- LULJA — I sjell unë të gjitha.
- LAJA — E solli gurin yt atë?
- LULJA — Po, e ka te shtëpia. Do ta bjerë vetë këtu. (*Dalin. Hyn Zeneli, i cili shikon gropën me çudi, mandej i bën me dorë Budes, e cila vjen me një kovë, gjoja për të mbushur ujë në pus*)



ZENELI — Ja, shikoje. Ç'do të thotë kjo?

BUDJA — S'po e marr vesh.

ZENELI — Këta patjetër diçka kërkojnë. I kanë rënë në erë. Kot nuk e thotë Beqir aga se u duhet ndër-ruar vendi.

BUDJA — Prit, prit, mos u ngut.

ZENELI — Çfarë mos të ngutemi?! Sot një gropë këtu, nesër një më poshtë, pasnesër fill e atje ku duhet. Mirë e ka Beqir aga që thotë se Sula, para se të vritej, do t'u ketë treguar partizanëve.

BUDJA — Po të ishte ashtu pse e hapin gropën këtu e jo aty ku është vendi?

ZENELI — Ndoshta nuk e ka ditur vendin me siguri. Edhe ai nga i ati e ka dëgjuar. Grua, duhet vepruar shpejt. Ndryshe na iku zogu nga dora.

BUDJA — Dale, dale; këtu është vendi ku është vlarë Xhemali. Po, pikrisht këtu. Mos gabofsha, sot mbushet viti. Sigurisht duan të ngulin ndonjë gur si kujtim. Kështu do të jetë. Po vjen Selim Myrtja me Havanë. Largohu ti këndeje se me mua flasin më hapur.

ZENELI — Mos e harro porosinë e Beqir agës. Kujtoja Selimit.

*(Zeneli largohet. Hyn Selimi bashkë me Havanë. Selimi ka në krah një gur të madh)*

HAVAJA — Mirëdita, zonja Bude!

BUDJA — Mirëdita, Hava! *(Falen)*

HAVAJA — Ti po mbush ujë kështu?!

BUDJA — Ç'të bësh? Shërbëtori na u largua.

HAVAJA — Po si ka qenë zotnia jote?

BUDJA — Ja, kështu si kohërat. Te Laja po shkoni kështu?

HAVAJA — Po, te Laja. Sot mbush vitin Xhemali.

- BUDJA — E mora vesh. Do të vij dhe unë me Zenelin.  
Po atë gur ç'e ke, o Selim?
- SELIMI — Na e kërkoi Laja. Do ta ngulë këtu te vendi ku u vra Xhemali, që ta ketë si kujtim.
- BUDJA — E gjora Laje, mbeti vetëm me Manin.
- HAVAJA — Ju thaftë dora atij që e bëri këtë gjaksi. Lamtumirë, zonja Bude, dhe të mirë ardhshi.
- BUDJA — Udha e mbarë. Ti, Selim, a po ndalon pak. Kam një fjalë me ty?
- HAVAJA — Po të jetë punë borxhi...
- BUDJA — Jo, o Hava, mos u bëj merak. Nuk kam punë borxhi.
- SELIMI — Kalo ti, grua, se po vij. (*Havaja largohet*)
- BUDJA — Desha të të lajmëroj se Beqir aga doli nga burgu.
- SELIMI — Kur kështu?
- BUDJA — Ka tri ditë. Mirë, po i kërkojnë edhe dy milion të tjera.
- SELIMI — Sa për vete unë nuk kam asnjë kacidhe. Borxhin ia njoh edhe do t'ia paguaj.
- BUDJA — Rri, o Selim, se nuk e vë kush në kandar borxhin tënd. Ai sa doli nga burgu pyeti për ty.
- SELIMI — Sigurisht, ka pyetur, por unë, pasha allahun, nuk kam.
- BUDJA — Ai pyeti si e ke hallin.
- SELIMI — A i the se ma kanë marrë djalin në ushtri?
- BUDJA — Ia thashë. I erdhi shumë keq. Nuk jam sjellë mirë, tha, me Selim Myrton. Ai është shpirt njeriu.
- SELIMI — Sa para bën kur nuk ke. Më vret borxhi i tij, po shpirti para s'bën.
- BUDJA — Do ta ndihmoj, tha, atë njeri.
- SELIMI — Mua të më ndihmojë Beqir aga?!
- BUDJA — Ja pra, edhe unë u çudita kur foli kështu. Do ta nxjerr në dritë Selim Myrton, tha.



SELIMI — More, le të mos më kërkojë borxhet ai, mjaft e kam.

BUDJA — Sa për borxhet flije mendjen kur të duash. Si e pashë unë punën, burgu e kishte bërë njeri krejt tjetër Beqir agën. Jam penduar shumë, o Bude, më thoshte, për sjelljen time të keqe kundrejt bujqve dhe shegertëve të dyqaneve dhe magazeve. Vetë zoti po na ndëshkon se nuk jemi kujtuar kurrë për vuajtjet e tyre por u kemi qëndruar përmbi zverk.

SELIMI — Beqiri i thoshte këto fjalë?!

BUDJA — Këto dhe të tjera. Do t'i dëgjosh me veshët e tu. Do të vijë këto ditë e do të të thërrasë. E ka përgatitur një peshqesh për ty. Çfarë nuk më tregoi, po, me sa ma merr mendja, më duket se don me të falë kullën e barit.

SELIMI — Je në vete, moj! Pse, u çmend Beqir aga?

BUDJA — Nuk jam e sigurtë, por aty më rreh mendja. Tani shko se po të pret Havaja në këmbë. Mos e bëj me fjalë as me Havanë. Udhë e mbarë, Selim, e paç fatin e bardhë! (*Selimi del i trullosur.*) U turbullua qerosi. Iu bë koka çorbë!  
(*Vjen Zeneli.*)

ZENELI — Hë?

BUDJA — Ashtu si mendova doli. Do vendosin një gur si kujtim.

ZENELI — I fole gjë Selimit për ato që të porositi Beqir aga?

BUDJA — I fola dhe e kurdisa mirë. As gjumi i natës nuk ka për ta marrë. Tani dëgjo këtu. Të vemi të vishemi e të shkojmë për vizitë te Laja.

ZENELI — Pse?

BUDJA — Ka përvjetorin burri i botës. U mbush një vit që u vra Xhemal Mani.



ZENELI — Aty po më rreh mua! Akoma nuk janë shfarosur të gjithë? Mua më përzihen zorrët kur e takoj Lajen në rrugë e jo më t'i vete për vizitë.

BUDJA — Ja pra që duhet t'i shkojmë, bile edhe t'i buzëqeshim. Si të bjerë lodra duhet të kërcejmë. Se mos kam dëshirë unë t'ia shikoj surratin Lajes. Hajt, nisemi se po vjen ajo bishtëpërdredhura e Selim Myrtos bashkë me ashikun e vet.

*(Budja me Zenelin largohen. Hyn Lulja me Manin.)*

LULJA — *(Duke shtruar një rrogos afër gropës)* Për pak na hetoi baba së bashku. *(Hedh edhe një shtrojë që ka sjellë Mani.)*

MANI — Unë thashë ç'pate që ike ashtu! Shumë frikë e ke babën.

LULJA — Nuk e kam aq prej frike, o Man, po nuk dua t'ia prish qëjfin.

MANI — Të pëlqen të jesh pranë meje? Thuaje, mos ki turp.

LULJA — Më pëlqen.

MANI — Edhe mua më pëlqen shumë. Po komuniste të pëlqen të bëhesh?

LULJA — Pse, nuk jam komuniste unë?

MANI — Ti komuniste je, po jo në Parti siç jemi unë e Laja.

LULJA — E pse nuk më fusni edhe mua në Parti? Unë po punoj përditë. Të gjitha punët, që më keni ngarkuar, i kam kryer.

MANI — Aha, të hysh në Parti nuk është aq lehtë. Duhet të japësh prova.

LULJA — Çfarë provash?

MANI — Së pari duhet të ia luash gishtin kësaj. *(Tregon një revole berretë të re.)*

LULJA — E ku ta marr unë atë? Më premtove se do të ma gjeje një.

MANI — Si të duket kjo?

LULJA — Revole berretë si e Qazimit. Kjo është shumë e bukur, po ç'e do, është e jofja.

MANI — Merre, se po ta fal.

LULJA — Me të vërtetë? Po ti? ✓

MANI — Kam tjetër unë. Desha të ta jepja si peshqesh kur të fejojemi.

LULJA — Tani ma bëre qejfin.

MANI — Dëgjo edhe prova të tjera. Duhet t'i urresh armiqtë, mos të kesh frikë nga kriminelët, pò t'ua numërosh në kokë.

LULJA — E ku t'i gjej unë kriminelët. ✓

MANI — Do përpiqesh me ta, mos ki frikë. Ja, këndeje rrotull vijnë vërdallë. Pastaj do të mësosh shkollë.

LULJA — E ku ta marr shkollën? ✓

MANI — Do të hapet shkolla. Na lajmëruan se do të na sjellin një mësues.

LULJA — Po do të mësoj unë, o Man? ✓

MANI — Je në vete! Do mësoj unë e s'do mësoke ti!

LULJA — Vërtet ti, Man, shkon natën me forcat e ndjekjes?

MANI — Shkoj, pse?

LULJA — Shkokan mjaft nga fshati ynë: Qazimi, Hyseni, Xheladini, Hysi...

MANI — E pse m'i thua këto?

LULJA — Atje të më marrësh një natë. Shih pastaj se a jam e denjë për të hyrë në Parti unë.

MANI — Fute armën në gji se po vijnë. (*Lulja largohet nga Mani. Hyjnë Laja, Havaja e Selimi*)

HAVAJA — Ja, pikërisht këtu. Unë po kullosja lopën në atë breg kur e pashë të shkretin Xhemal që do li nga shtëpia e Beqir agës dhe u drejtua nga je-



revia<sup>1)</sup> e vet. Sytë në të i kam pasë kur ka krisë mauzeri. Xhemali i zi bëri dy-tre hapa dhe ra këtu përmbys. Unë e solla mbarë.

LAJA — Po plumbi nga t'u duk se erdhi?

HAVAJA — Jam krejt e bindur se ka ardhë nga dritarja qorre e bodrumit të Beqir agës.

SELIMI — Mos fol budallallëqe.

LAJA — Mos u çudit, o Selim. Ky pallat ia hëngri kokën asaj kaçorres<sup>2)</sup> sonë. Kështu ka qenë gjithmonë. Po tani u kthye bota ndryshe këtu te ne. Kaçorret tona po ia hanë kokën të zotit të këtij pallati. Çfarë ke? Më dukesh ca i turbulluar.

SELIMI — Jo, jo s'kam gjë.

LAJA — Apo akoma nuk bindesh që Beqir aga na ka marrë të keqen. Më ndihmo ta ngulim këtë gur. (*E ndihmojnë Selimi e Mani. Laja flet duke shikuar gurin*) Eh, o i zi, u robtove gjithë jetën për një kafshatë bukë. Pemët që rrisje ti çudisnin Shkodrën. Të vranë e nuk të lanë t'i shikoje këto ditë, që i prisje si ujët e pakët. Mjaft të shikoje Beqir agën në burg! Të zhdukën edhe ty, o Sulë, shegerti i motrës! Ta pinë gjakun zotnitë e pazarit. Ndaj i luftove me aq tërbim.

HAVAJA — U erdhi fundi edhe zotnive...

LAJA — Prit, prit, o Hava, kanë borxhe për të larë ata. Po ç'e do që as baba, as Sula i shkretë nuk po i shohin këto që po ndodhin këtu.

HAVAJA — E shfarostë murtaja atë që e bëri një hata të tillë. Kush thua e bëri këtë?

LAJA — Sigurisht një që na njihte mirë. Tjetërkush nuk e dinte që Sula kishte ardhë atë natë nga ma-

1) jerevi — kthinë përdhese, pa dysHEME.

2) kaçorre — kasolle e vogël, kolibe.



li për të parë babën e vrarë. Nga frika se mos rrethohej shtëpia vajti e fjeti në fushë bri një mullari. Atje e kapën xhandarët dhe ia dorëzuan gjermanëve.

SELIMI — Te cili të qan zemra, o Laje?

LAJA — Si doras<sup>1)</sup> më qan zemra te Halil Nurja, zagari i shtëpisë së Beqir agës. Ai u bë kokë e këmbë me gjermanët dhe tani kushedi nga bredh që të shpëtojë kokën.

HAVAJA — Hë e marrtë mortja!

SELIMI — Edhe unë te Halili e kam dyshimin. Po pra për them me vete: çfarë e shtyu atë të bëjë një gjë të tillë?!

LAJA — Beqir aga.

SELIMI — E pse Beqir aga?

LAJA — Ja pra, këtë nuk po e gjej dot. Duhet të ketë pasë një hall të fortë.

SELIMI — Për Beqirin nuk më mbushet mendja. Ç'nevojë kishte ai të vriste Xhemalin, që e kishte kop-shtarin më të mirë të Shkodrës. Prej tij fitonte tri herë më shumë se nga ne bujqit. Kështu thotë edhe Zenel Dani.

LAJA — Po thënka një burrë i mirë. Nuk është çudi që edhe ai ta ketë ngjyer kafshatën në këtë çorbë të ndyrë.


HAVAJA — Për Zenelin nuk mund të them gjë, por ajo Budja është një gjarpër...

SELIMI — Pusho ti, moj dreq. Ç'punë ke ti me Buden?

LAJA — Pse, ke frikë se të nxjerr nga toka?

SELIMI — Jo, për tokë më merr të keqen ajo sot, po pse të përzihesh në punët e tyre. Nuk del gjë e mirë nga ata.

1) doras — ai që ka vrarë një njeri me dorën e vet.



LAJA — Jo, e mira nuk del, por e keqja të ka dalë gjithë jetën.

HAVAJA — Ashtu është, o Laje. Na kanë përdorur si kafshët.

SELIMI — Epo kështu ka qenë zakoni kudo. Të gjithë të pasur nuk mund të ishim. Mandej se mos kanë qenë më të mirë zotnitë tjetërkund. Bile këta kanë qenë lule.

LAJA — Ç'paske kështu sot, o Selim? Mos ke fjetë përmbys?

SELIMI — Pse, a po flas keq? Bile ata edhe na kanë ndihmuar kur kemi rënë ngushtë.

LAJA — Sigurisht gjithë gjakun nuk na e kanë pirë menjëherë, po dalngadalë e pak nga pak, ku me faiz e ku me borxhe.

HAVAJA — *(Me kafenë që ka sjellë Lulja.)* Për të mirë, o Laje. U harruam ndër biseda. Sa më parë e pafshim një gëzim në shtëpinë tënde!

LAJA — Të lumtë goja, o Hava. Sulës së shkretë nuk ia pashë dot dasmën. Mendoj t'ia shoh... *(Shikon Lulen)* Ti, Lule, shiko pak mos e lashë derën e shtëpisë çelë e më hyjnë pulat. Ik andej edhe ti. *(Mani dhe Lulja dalin në drejtime të kundërta)* Ku e kisha fjalën?

HAVAJA — Te dasma e Sulës.

LAJA — Po, prandaj desha t'ia shoh dasmën Manit. Vetëm ai më ngeli, o Selim.

SELIMI — A s'është pak si i ri?

HAVAJA — Çfarë i ri! Djali është tamam kapedan. T'ia shohësh dasmën, o Laje, dhe sa më parë bile.

LAJA — Po duhet nusja, o Hava.

HAVAJA — Për nuse qan hall ti? Nuse ka sa të duash. Ti veç hap gojën.



- LAJA — E pse ta lypim andej e këndeje kur e kemi te dera e shtëpisë.
- HAVAJA — Për cilën e ke fjalën ti?
- LAJA — Për Lulen. Çfarë ke, të duket e çuditshme? Pse nuk po flet?
- HAVAJA — Ty të falem nderit, o Laje. Unë nuk e shaj djalin, as shtëpinë. Po në këto punë është zakoni të flasin burrat më parë.
- LAJA — Mirë, po Selimi e ka kyçur gojën. Pa fol, o Selim!
- SELIMI -- Ç'të flas. Kjo më erdhi e papritur.
- LAJA — Edhe aq e papritur nuk besoj se ka qenë. Ti i ke parë sa herë së bashku.
- SELIMI — Unë kam menduar se ata bisedonin për punë luftarë, o Laje. Ta dija se Mani kishte qëllime të tilla, unë një minutë nuk e lija vajzën me të. Jemi të varfër, po nderin e kemi gjënë më të shtrenjtë.
- LAJA — Dale, mos merr zjarr. Këtu nuk ka asgjë të keqe. Ata njihen që të vegjël. Shtëpitë tona s'ua kanë fshehur kurrë gratë e vajzat njëra-tjetrës. Lufta ata i bëri të njihen edhe më mirë. Tani unë vi e ta kërkoj. Ç'të keqe ka këtu?
- SELIMI — Këto punë nuk bëhen fët e fët. Dale, të mendohem një herë.
- LAJA — Unë them se këtu nuk ka ndonjë gjë të madhe për t'u menduar.
- SELIMI — Se mos kam vetëm këtë hall. Mua më vlon koka.
- LAJA — Hallin e borxhit ke ti?
- SELIMI — Po edhe hallin e tij e kam.
- LAJA — Asnjë lek nuk duhet t'i japësh Beqir agës.
- SELIMI — Një fjalë goje! Po fytyra?
- LAJA — Fytyra? E ku ka Beqir aga fytyrë. Ai qeros

të ka ngritë e qeros të ka ulë. Një herë nuk të ka thirrë me emër. Deri dje na ka rrjepë ai ne. Sot ai duhet të na lajë hakun. Ti do të marrësh tokë dhe bagëti.

HAVAJA — Ty të lumtë goja! Aman të dalim në dritë një herë.

SELIMI — Po Beqir aga ka tapitë.

HAVAJA — Eh, o Selim i shkretë, kurrë s'u bëre njeri. Ato tapi që ka ai, le të vejë e t'i varë, mender jush, në nevojto. Tapitë i kemi ne. E pe si ia përlanë dyqanet dhe shtëpitë në Shkodër? Të gjitha do ia marrin. Edhe pallati do të shtetëzohet.

SELIMI — Mandej kam edhe dasmën e Rakipit e nuk kam grosh në xhep.

LAJA — Sa për dasmën e Rakipit ndihmojmë njeri-tjetrin e nuk të lëmë keq. Pra, mos kërko t'ia prishësh zemrën të rinjve për hatër të Beqir agës. Mendo se ata e duan njëri-tjetrin.

SELIMI — Nuk janë kaq të lehta këto punë.

LAJA — Edhe aq të rënda sa të duken ty nuk janë. Si thua ti, Hava?

HAVAJA — E ç'të them, o Laje. Për mua fat më të mirë nuk gjen bija ime. Edhe me Rakipin kam biseduar. Ai është gati ta japë me të dyja duart. Po ne gratë duhet të bëjmë ashtu si thonë burrat.

LAJA — Po fol, o Selim Myrtja.

SELIMI — Ç'të flas; e shoh se e paskeni përgatitë këtë punë.

LAJA — E po na përket ta vemë dorën në zemër para se të gjykojmë mbi fatin e fëmijëve tanë.

HAVAJA — Më dëgjo edhe mua një herë, o burrë! Ta japim vajzën.

SELIMI — Ta marrë djalli, s'di njeriu si të veprojnë as me fëmijën e vet. Ç'u ngatërruan kështu këto punë.



LAJA — Nxirre atë të shkretë fjalë. Bëju burrë, o Selim, se borxhet e tua ia laj unë Beqir agës.

SELIMI — Po a s'bën të mendohem një çikë?

LAJA — Po edhe mund të mendohesh, o Selim, po kjo është një ditë e shënuar për mua. Një vit para këtu më vranë babën, një vit pas po këtu dua të fejoj Manin dhe të lehtësoj njerën plagë. Pra, një fjalë e jotja për mua vlen sa të thuash sot.

SELIMI — Ta marrë djalli, bëni si të doni. Epo duket ky paska qenë fati i tyre.

LAJA — Të lumtë! Tani ma bëre qejfin.

SELIMI — Të varfër e çuam jetën, të varfër le ta çojnë edhe këta.

LAJA — Këtyre mos ua qaj hallin, o Selim. Jeta e tyre do të jetë krejt ndryshe.

HAVAJA — Po vjen Zenel Dani me Buden.

LAJA — Po këta ç'djall i solli?

HAVAJA — Vijnë për kryeshëndoshë. Kështu na thanë kur u takuam me ta.

LAJA — Tani po u dhimbsen këtyre njerëzit e mi?  
(Hyjnë Zeneli me Budën).

ZENELI — Mirëdita!

HAVAJA — Mirë se vini!

BUDJA — Sa mirë që paskeni zënë vend këtu! Ja po ulemi edhe ne.

ZENELI — (Ulet) Qofshi mirë, o Laje, e marrshi ndonjë lajm edhe nga Sula.

LAJA — Të vdekurit nuk dërgojnë lajme, o Zenel.

BUDJA — Kam dëgjuar se janë kthyer disa, o Laje, që shtëpitë i kanë qarë. Allahu, ishallah, ka dhembje për ty e ta sjell shëndoshë e mirë.

LAJA — Çfarë merr mortja nuk e kthen më në jetë.

HAVAJA — Kush e bëri, iu thaftë dora.

- LAJA — Dora po i thahet përditë, o Hava, po shpejt do t'i thahet edhe trupi.
- BUDJA — Atë duam ne të gjithë, o Laje.
- LAJA — Jo të gjithë, o Bude. Po të ishte ashtu nuk do të vritej Xhemal Mani, as do humbiste Sula.
- ZENELI — Sikur nuk po i kuptoj këto fjalë.
- LAJA — Si e ke Beqir agën, o Zenel?
- ZENELI — Për Beqirin e ke fjalën?
- LAJA — Po, për Beqirin.
- ZENELI — E di se tek ai të qan zemra, por i bie në qafë kot. Ai nuk të ka gisht në këtë vrasje.
- LAJA — Unë të pyeta si është me shëndet.
- ZENELI — Ashtu si ka urdhëruar zoti.
- LAJA — Kishte dalë nga burgu.
- ZENELI — Po, me kusht që të grumbullojë edhe dy milionë. Ndryshe e rrasin prapë brenda.
- LAJA — E ç'janë dy milionë për të!
- ZENELI — Po, se milionat janë gurë zalli! Ai çfarë pati: me dyqane, me mall, me para, i dorëzoi të gjitha.
- LAJA — Ka prapë ai, ka!
- ZENELI — Po, kështu mendojnë bota. Nuk kanë të ngopur ta shikojnë lakuriq.
- LAJA — Prapë mirë lakuriq, po nuk kanë të ngopur ta shikojnë në litar.
- BUDJA — Subhanë allah! Mos e thuaj atë, o Laje, se edhe ai është njeri i zotit!
- LAJA — Eh, ç'është ai!
- ZENELI — Ters po e bën këtë bisedë, o Laje.
- LAJA — Nuk po të pëlqen?
- BUDJA — Nuk ka faj, o burrë, ka dy plagë në zemër.
- ZENELI — E ç'faj kemi ne?
- BUDJA — Laja nuk e ka me ne.
- ZENELI — Kur e ka me Beqir agën e ka edhe me ne.



LAJA — Tani fole mirë. Harrova të të pyes, po Halil Nuren si e kam?

ZENELI — Ç'punë kam unë me Halil Nuren!

LAJA — Mos e braktisni kështu të shkretin Halil. E ke-  
ni pasë mik. Është rritë në shtëpinë e Beqir agës.

ZENELI — Secili dash varet në këmbën e vet. Unë nuk  
merrem me të arratisur. Ai ka vrarë kurse unë  
kam shikuar punën time.

LAJA — Ka vrarë, ka tortuar, ka çnderuar. Le ta fshih-  
ni ku të doni, plumbit tonë nuk i shpëton.

ZENELI — Ne nuk fshehim njeri as nuk merremi me  
punë të tilla. Mjaft kemi telashet tona. Pra, mos  
na ngatërro kot në gjëra që nuk i bëjmë. Halili  
po. Ai duhet t'i paguajë vrasjet e tij, megjithëse  
betohej që nuk kishte gisht në vrasjen e Xhemal  
Manit.

LAJA — Sigurisht, gishtin atij ia luajti tjetërkush.

ZENELI — Ti mendon për Beqirin, por po të betohem  
se ai nuk të ka as hak as hile.

BUDJA — E ku e di ti, more burrë? Se mos t'i tregon  
gjarpri këmbët!

ZENELI — Grua, ç'janë këto fjalë?

BUDJA — Mos thirr. Se mos të pyeti ndonjëherë Beqir  
aga në punët e tij.

ZENELI — E kemi zotninë tonë, grua, dhe për më te-  
për jemi edhe kushërinj, nuk duhet t'ia vëmë kë-  
mbën tani që qeveria po e rrokullis poshtë.

BUDJA — Ne hamë në sahan tonë e ai ha në sahan të  
vet.

LAJA — Mirë e ka Zeneli, Bude. Nuk është mirë t'ia  
veni këmbën Beqir agës.

ZENELI — Atij të ziut i ranë mjaft telashe përmbi  
kokë.

LAJA — Tani e prishi Zeneli.

ZENELI — Pse?

LAJA — Atij i kanë rënë fare pak telashe deri tani.

ZENELI — Po, kështu u duket disave. Si ka qenë burri i botës: me pare, mall e pasuri si mali me borë. Të gjitha ia përlanë dhe e lanë gisht. Nuk mjaftoi kjo, por e futën edhe në burg. E ku është i zoti ai t'i bëjë ballë burgut. E si është mësuar ai!

LAJA — E drejtë! Burgjet kanë qenë gjithmonë për të varfërit. Ja pra se erdhën kohërat, o Zenel, që të mësohet edhe Beqir aga me burg; dhe të mësohet kaq bukur sa kam shpresë që në burg t'i dalë edhe shpirti.

ZENELI — Mos fol ashtu, o Laje, se nuk ke pasë keq prej tij. Mos i harro të mirat që ke parë nga ai. Sa herë që ngelte keq yt atë tek ai e përplaste kokën.

LAJA — Dhe ai ia rripte lëkurën.

BUDJA — More burrë, ç'paske sot kështu. Nuk na le fare të bisedojmë.

ZENELI — Pse, mos deshe më tepër se kaq? Ne erdhëm të nderojmë kujtimin e Xhemalit të shkretë.

LAJA — Edhe sikur të mos vinit, nuk do të më ngelte hatri.

ZENELI — Atëherë na falni.

HAVAJA — Po rrini, rrini e pini një kafe.

ZENELI — Jo, pimë mjaft. Na gostiti Laja që mos e lyp më mirë. Po thuaj ti ku dijnë komunistët se ç'janë nderet.

LAJA — Komunistët mos m'i zë në gojë po të them se ia sheh sherrin trashë kësaj pune.

BUDJA — Nuk e menduam se do të na prisje kështu, o Laje. Megjithatë edhe Zeneli nuk diti të silllet e biseda mori ters. Ju ardhshim për të mirë mbas sodit. *(Dalin Zeneli e Budja)*

HAVAJA — E zeza, si ua punoi.



LAJA — Pse, nuk e meritonin?

HAVAJA — E meritonin edhe më zi. Mua më bëhej zemra mal kur u flisje, po çuditesha ku e gjeje gjithë atë guxim!

LAJA — E çfarë do të më bëjnë? Mos do të më nxjerrin nga shtëpia? Ata janë garuzhda e Beqir agës. Sot u kanë rënë pendët e rrijnë si pula të lagura. Dje-pardje kishin të vështirë të pështynin mbi ne. Ç'ke, o Selim, që po mendohesh?

SELIMI — Po çuditëm.

LAJA — Mos u çudit aspak. Po s'ua punuam kështu, nesër i kemi prapë mbi zverk.

SELIMI — Nuk e kam menduar ndonjëherë se Zenel Dani do të poshtërohej në këtë mënyrë.

LAJA — Prit, prit! Sa do të shohësh!

## Tabloja e dytë

*Dhomë e madhe në shtëpinë verore të Beqir agës. Mobilje të vjetra orientale, musandra, mindere, ilahi, sergjene, trapazana etj. Në dhomë Budja, tek pi kafe në minder, shikon nga dritarja. Diku larg dëgjohet një këngë me zëra të rinjsh.*

*Unë po due me ju skjarue  
Ballin kush e ka formue etj.*

BUDJA — Tfu, ju preftë kolera të gjithëve. Na i çatë veshët me këto këngë të mallëkuara. Përditë kështu. Po kërceni! S'keni faj. Ju erdhën ca ditë edhe juve dhe nuk latë gjë pa bërë! Të gjitha i kam të shkruara këtu në zemër. Kërceni, këndonni se botë i thonë kësaj. Do kalojnë edhe ditët tuaja. E atëherë ku do të veni, more të zes!

ZENELI — *(Nga jashtë)* Qelbësirat e dreqit!

BUDJA — Çfarë ke, o burrë, që turfullon?

ZENELI — *(Hyn me një shportë në dorë)* Vajta të vjel një shportë nga ato qershitë e mëdha për Beqir agën në bahçe të Selmanit kur më doli Selmani me dy të bijtë. Të tre me nga një kopaçe në dorë. More kjo është bahçja e Beqir agës, u thashë. Ejani në vete! Na ka thënë Laja asnjë kokërr qershi Zenel



Danit, bërtisnin. Bahçja është jona. Dësh ma prishën edhe shportën.

BUDJA — Mirë ta bënë. Ç'të duhen qershitë, o i zi! Shiko të mëdhatë e mos u merr me vogëlsira. Të paska metë Beqir aga keq për qershi. Hajde ulu se t'u ftoh kafja.

ZENELI — Janë tërbuar fare me burra e me gra. Ca të rinj kanë nisur edhe të më tallin rrugës.

BUDJA — Mirë, mirë, mos e prish gjakun.

ZENELI — Apo s'është bërë edhe ajo Laja...

BUDJA — Unë mendoj se për t'ia arritur qëllimeve tona Laja është kryesorja. Po e mundëm atë e fituam davanë. Po të mos harrojmë edhe Halilin. Fundi i fundit me Halilin e kemi më lehtë. E kupton çfarë të them, apo e ke mendjen gjithnjë te qershitë.

ZENELI — E kuptoj, e kuptoj. Laja është bërë e padurueshme.

BUDJA — Sa bukur ta përmbloodhi atë ditë. Shumë mirë ta punoi. Sjellja jote që prej budallai.

ZENELI — Epo duroheshin fyerje të tilla nga një harbutkë.

BUDJA — Ajo harbutkë është kthyer në një bishë të egër që kërkon të na gëlltisë me gjithë rroba.

ZENELI — Do t'i them Halilit ta qërojë. E ka bërë hak plumbin.

BUDJA — Bukur besa! Edhe ajo na duhet. Të kalbemi në burg ose të hamë edhe ndonjë plumb. As Laja as Mani nuk duhen prekur. Bile duhen ruajtur. Nuk e dimë sa kohë do të qëndrojmë nën këtë qeveri të djallit. E gjatë kësaj kohe Laja na duhet patjetër. Në asnjë mënyrë nuk duhet të shkojmë në burg. Burgu u vë kapak të gjithë qëllimeve tona. (Zenelit, që ka dalë e shikon në dritare.) A duket gjë?

*lindim dhe shpirtin me bes dhe shpirtin  
sper sola po e driten in. Kuvendi*

- ZENELI — Asgjë. Shumë po vonon.
- BUDJA — Mbase nuk vjen fare sot. Kushedi ç'telash tjetër i ka mbirë.
- ZENELI — Telashin më të madh ai e ka këtu. Këtu ka zemrën dhe shpirtin. Ai i jep të gjitha, me gjithë djalë që ka në Itali, veç për të shpëtuar këto, që ka këtu.
- BUDJA — Shiko se këto ditë je zverdhur në fytyrë.
- ZENELI — Epo s'i thonë shaka, o grua. Janë aq shumë, sa të luan tepeleku i kokës.
- BUDJA — E pastaj?
- ZENELI — E pastaj? Më dridhet trupi kur mendoj se mund të më ikin nga dora. Dua t'i kem të gjitha unë... unë e djemtë e mi. Neve na përkasin. Baba i Beqirit ia mori me dredhi babës tim pasurinë dhe e la me gisht në gojë, megjithëse ishin vëllezër. Pse mos të vijë prapë malli tek i zoti? Pse mos ta gëzojmë ne atë pasuri, që me gjyq im atë nuk e arriti dot? Beqir aga na solli këtu se s'i beson njeriu. Po nesër, po t'i vijë dita, na nxjerr jashtë me një faleminderit e udhë e mbarë!
- BUDJA — Mbarove?
- ZENELI — Mbarova. Pse?
- BUDJA — E di që me këtë fytyrë padit veten para Beqir agës?
- ZENELI — Po ja, ta marrë djalli, nuk më lë frika ta marr veten. Po sikur t'i vijë goja Zylfie hanmit? Ajo i di të gjitha.
- BUDJA — Zylfie hanmi ka marrë fund njëherë e mirë. E pashë me sytë e mi. Ajo nuk do të flasë kurrë më në këtë jetë. Na e ka marrë të keqen. Pra, le mos të të dhimbset.
- ZENELI — Në xhehnem i vaftë shpirti. Po e bija. Ndoshta Beqir aga ka folur me të.

*Vjerme, i shpirtit nga jetimin nuk pyjet  
as për jetën*



BUDJA — Atë e kam unë në kujdes. Ia mbyll unë gojën përjetë. Të thashë pak përpara mos të harrojmë edhe Halilin. Pas Lajes, ai është njeriu më i rrezikshëm për ne. Ai, si i arratisur, nuk e ruan dot pasurinë e Beqir agës nga komunistët. Ai ruan pasurinë e zotnisë nga ne; nga unë e nga ti.

ZENELI — Ca dyshime i ka shfaqë Halili edhe tek unë këto ditë.

BUDJA — Nuk është çudi që Halili të ketë ndër mend të na zhdukë ne bashkë me Beqirin.

ZENELI — Kjo nuk më ka shkuar ndër mend.

BUDJA — Ai mund ta mendojë një gjë të tillë, po na merr të keqen. Nuk ka kërcik<sup>1)</sup> ai të kapet me Buden.

ZENELI — Sidoqoftë, duhet të ruhemi nga ai. Është katil i madh. E vrau atë ditë Xhemal Manin dhe erdhi e vazhdoi lojën e spathive dhe fitoi. Nuk ka shpirt ai!

BUDJA — Për fat nuk ka as kokë. Tani rri e dëgjo dhe futi mirë në mend fjalët e mia.

ZENELI — Çfarë!

BUDJA — Do ta hedh në bixhoz kullën e barit.

ZENELI — S'po të marr vesh.

BUDJA — Do ta hedh në bixhoz kullën me të gjitha: me drithë, dhe me mall që ka poshtë në bodrum.

ZENELI — Grua je në vete?

BUDJA — E kam shqyrtuar nga të gjitha anët. Nuk kemi rrugë tjetër. Duhet të japim një që të mbrojmë nëntë dhe njëherit edhe kokat tona.

ZENELI — Asgjë s'do t'u japim atyre maskarenjve!

BUDJA — Atëherë do të na i marrin të gjitha e me to bashkë edhe kokat tona. Pranon?

1) s'kam kërcik — s'kam fuqi (fig.)

ZENELI — Grua, e di çfarë do të thotë kulla e barit?

BUDJA — Po ti e di se po u zbulua drithi ty të parit mund të të vejë koka? Akoma nuk i njohe ligjet e këtyre? E di se ushtria mos sot nesër mund ta heqë barin andej për bagëti. Dhe, po u hoq bari del drithi. Ja pra për çfarë na duhet Laja, o burrë. (Trokitje me sinjal.)

ZENELI — Është ai. Prapë ka dalë nga vendi.

BUDJA — Do të bisedojmë më gjatë për këtë. Shko e sille. Le ta gërmojmë pak, të shohim si e ka mendjen. (*Zeneli del e hyn me Halil Nuren.*) Si je, o kapedan?

ZENELI — Çfarë kapedani? Ky nuk tregohet fare i kujdesshëm.

BUDJA — Rri, ore ti, se të ka hyrë lepuri në bark. Shko e ruaj jashtë mos po vjen njeri. (*Zeneli del.*)

HALILI — Mirë ia bëre. Frika pa vend të merr në qafë.

BUDJA — Më thanë se nga dritarja qorre e bodrumit e shikon shtëpinë e Lajes.

HALILI — Si në pëllëmbë të dorës.

BUDJA — E çfarë duket andej?

HALILI — Tani ajo shtëpi është bërë për ta djegur me benzinë. Kush nuk hyn e kush nuk del andej, ofi-cera, partizanë, djem të rinj, vajza të reja. Tamam bordell.

BUDJA — E po, si i thonë ata, kryetare e këshillit-bija e botës. I ka ardhë dita. Kurse ne duhet të durojmë.

HALILI — E deri kur, o Bude.

BUDJA — Punët e mira bëhen ngadalë e me durim. Po e humbëm durimin i humbëm të gjitha. Laja atë do. Po ne duhet t'ia hedhim edhe Lajes.

HALILI — Lajes i do hedhur kjo bombë.

BUDJA — Edhe ti si Zeneli. E di se një gjë e tillë na



merr në qafë të gjithëve, me gjithë Beqir agën? Ti mund të ikësh në mal, pa mendo se ti i vetëm nuk e gëzon dot pasurinë e Beqir agës po nuk u zhdukën këta që kemi brenda.

HALILI — Unë i vetëm s'kam pasë ndër mend kurrë ta gëzoj pasurinë e Beqir agës, o Bude, pra mos m'i thuaj mua ato fjalë.

BUDJA — Fjala vjen, Halil; mos i merr për së prapthi fjalët e mia.

HALILI — Fjalët kur thuhën mbarë nuk kanë nevojë të merren për së prapthi.

BUDJA — Unë e di se edhe ti, si ne, jeton vetëm për Beqir agën. Pa të as frymë nuk marrim.

HALILI — Jetojmë në kohë të këqia, o Bude. Prandaj duhet të shtrëngojmë mirë njëri-tjetrin. Po hyri dyshimi mes nesh na ka marrë lumi.

BUDJA — Për kokë të djemve nuk e pata me ndonjë qëllim. Po ti nuk ke faj. Këta djall komunistësh po na prishin edhe nga mendtë. Çuditëm si i duron të gjitha këto Beqir aga. Shumë i fortë paska qenë!

HALILI — Edhe unë po duroj si gjarpri nën gur.

BUDJA — E di! Eh, si je mësuar ti! Po ja që murit me kokë nuk i bihet.

HALILI — Edhe ti nuk po kujdesesh për mua.

BUDJA — Për çfarë!

HALILI — Nuk ma solle Zadën njëherë po më le beqar në gropë të bodrumit.

BUDJA — Je në vete! Edhe ajo na duhet! Apo nuk llap Zadja. Prit, duro sa t'i përzemë komunistët pa do të të gjej unë njëmijë herë më të mira se Zadja.

ZENELI — (Hyn.) Po vjen Beqir aga.

BUDJA — (Halilit) Ik e futu në dhomën time. Mos të të shohë Beqir aga jashtë e zemërohet. Njëqind herë e ka porositur Zenelin. (Halili del).

ZENELI — Hë, si duket ky miku.

BUDJA — Nuk i tregon gjarpri këmbët. Shko e prite zotninë. *(Zeneli del dhe hyn me valixhe në dorë. Pas tij Beqir aga).*

ZENELI — Urdhëro, urdhëro!

BUDJA — Mirë se na erdhe, Beqir aga! Shyqyr që po të shohim njëherë e po na e ndriçon shtëpinë siç e ke ndriçuar gjithmonë!

BEQIRI — Ehë, ikën ato kohë!

BUDJA — Mos e thuaj atë, zotni Beqir. Mos na e copëto zemrën.

BEQIRI — Sot ne po kalojmë kohën e djallit. Edhe këlyshët e harbutëve janë çmendur, Më gjuajtën me gur në të hyrë të fshatit. Për pak më goditën në kokë.

BUDJA — I shfarostë kolera!

BEQIRI — *(Ulet)* Ku u lodha kështu, pra me karrocë erdha.

ZENELI — Rrugë e keqe, zotni Beqir.

BEQIRI — Sot çdo gjë është bërë e keqe. Zi më shohin sytë kudo. Si je, o Bude?

BUDJA — Në saje të zotit e tënden mirë do të jemi. Po si ka qenë zotnia jote? Ishe në burg, medet!

BEQIRI — As derrat mos e kalofshin si e kalova dhe si po e kaloj unë përditë.

BUDJA — E zeza unë sa do të kesh vuajtur në burg. Besojë, gjumi i natës nuk më zinte kur mendoja se ku e kishin futur zotninë tënde.

BEQIRI — Për burgun nuk e çava fort kokën, o Bude, po këta po më rrjepin për së gjalli. Po ma pijnë gjakun si shushunja. Ku e paskan mësuar këtë shkollë të djallit. Kemi thënë se ne tregtarët jemi të zgjuar. Asgjë nuk paskemi qenë. Këta paskan kryer universitet për të na ardhë hakut.



BUDJA — I mësoi djalli që kur braktisën zotin.

BEQIRI — Po sa budallenj që u treguam, sidomos ne tregtarët. Si nuk na vajti në mënd se do të vinte kjo ditë! Po unë e jepja gjysmën e pasurisë. Prapë më shpëtonte gjysma tjetër. Po këta të lënë lakuriq dhe kërkojnë të të rrjepin edhe lëkurën se gjoja e paske fituar me djersën e popullit.

BUDJA — Na marrshin të keqen.

BEQIRI — S'e di, o Bude, po deri tani të keqen po ua marim ne, që mos e pyet!

BUDJA — Më fal se po të them, zotni Beqir, po ti nuk u tregove aq budalla sa shokët e tu tregtarë. I re prapa mallit me kohë dhe ia gjete vendin.

BEQIRI — Të shohim, o Bude. Nuk ua hedhim lehtë këtyre. Këta edhe të vdekurit i nxjerrin nga varret dhe i kontrollojnë mos kanë fshehur flori.

ZENELI — Ti, Bude, nuk më le të bëj pak muhabet me kushëririn. Po si je, zoti Beqir, si është Zylfie hanmi. (*Budja ka dalë të përgatisë kafënë.*)

BEQIRI — Pse po të ha malli për Zylfie hanmin?

ZENELI — Si nuk më ha malli, zoti Beqir? E kam gruan e kushëririn dhe zonjën e zotërisë sate. Ne jetojmë nën hijen tuaj. Mjaft pa edhe ajo e shkreta sa prej sikletit iu mor edhe goja. Apo do zoti e i ka ardhë prapë goja?

BEQIRI — Do t'i vijë kur të flasë me gjyshërit në atë dynja.

ZENELI — Mos e thuaj atë, o Beqir, se është gjynah. Po vajza si është, mërzitet?

BEQIRI — Ore, leri ato biseda se janë pemë pa kokrra. Pa më thuaj si venë punët kënde!

ZENELI — E ç'të them unë i mjeri!

BEQIRI — Më mirë të flas me Buden. (*Thërret*) Ç'u bëre, o Bude?

- BUDJA — (*Nga brenda*) Erdha, Beqir aga, erdha!
- ZENELI — Më duket se ia kanë vënë syrin kullës së barit. Gojë nëpër gojë më ka ardhë në vesh kjo fjalë. E kërkon ushtria barin për kafshët.
- BEQIRI — Asnjë fije bar. E di se po të hiqet bari del drithi? Mos duhet t'i mbajmë me bukë ata që po na rrjepin për së gjalli?
- ZENELI — Helm duan ata, po si t'ia bëjmë? (*Hyn Budja me tabakanë e kafesë dhe gotën e ujit.*)
- BEQIRI — Kanë ngelë bark thatë e me leckat e trupit. Kërkojnë të ndreqin urat e shtëpitë e botës me pasurinë tonë. Kërkojnë të ndërtojnë qeverinë me koskat tona dhe ne të na hedhin si limon të shtrydhur. Kjo të shtie tmerrin ta shikosh në ëndërr.
- BUDJA — Mos u helmo kështu, zoti Beqir. Nuk të bën mirë.
- BEQIRI — E pse të rroj, që të shoh të tilla gjëra?
- BUDJA — Mos e thuaj atë. Po neve ç'na duhet jeta pa ty!
- BEQIRI — (*Zenelit*) Shiko, duhet larguar bari e drithi andej.
- ZENELI — Ashtu kam menduar edhe unë, Beqir aga, po si mund të largohen treqind dengje bar e qindra kuintalë drithë pa rënë në sy të këtyre maskarenjve!
- BEQIRI — (*Mendohet*) Atëhere duhet vepruar ndryshe. Ti, Bude, bisedove me Selim Myrton?
- BUDJA — Bisedova.
- BEQIRI — Hë, çfarë tha?
- BUDJA — Shkoi si i hutuar nga gëzimi. Tani i çova fjalë të vijë e të të takojë.
- BEQIRI — Mirë bëre. Pra, ai do ta pranojë kullën.
- BUDJA — Si s'e pranon, zoti Beqir!
- BEQIRI — Edhe tapinë e kam gati. E rregulloi Abdu-



lla efendia. Njëherë mendoja t'ia falja kullën për të shpëtuar mallin që është në bodrum derisa të zhdukej kjo farë e ndyrë. Mirëpo punët po na shkojnë gjithnjë rrokoll<sup>1)</sup> e teposhtë. Rrezikohet bari e nga bari drithi.

ZENELI — E po të zbulohet drithi mund të na fusin edhe në burg.

BEQIRI — Hallall burgu, po mos na japin edhe ndonjë karamele. Këta s'e kanë për pesë të të quajnë sabotator. Prandaj kullën e barit do ta djeg.

ZENELI — Po e djeg?

BEQIRI — Po, do ta djeg. Asgjë nuk duhet të bjerë në dorën e komunistëve.

BUDJA — Po nuk ka rrezik kjo punë?

BEQIRI — E pse të ketë rrezik? Malli është në bodrum i mbuluar me çimento.

BUDJA — E kam fjalën për komunistët, Beqir aga.

BEQIRI — Po ne nuk po e djegim kullën. Atë do ta djegin të arratisurit. Ne bile do ta ruajmë kullën prej tyre. Do ta ruajë Selim Myrtja, i zoti i kullës. Ai do të lejë kokën e tij qerose për të mos i lënë të arratisurit që ta djegin.

BUDJA — Po e hanë komunistët këtë, Beqir aga?

BEQIRI — Epo fundi i fundit kulla nuk është mall shteti.

BUDJA — Komunistët janë të çuditshëm, Beqir aga. Ata i kërkojnë gjërat deri në një qime. Për vete nuk e çaj kokën po kam frikë për zotniqë tënde.

BEQIRI — Epo më mirë të digjet se të bjerë në dorën e tyre. Miqtë e Halilit janë gati. Bile ata kishin pasë ndër mend ta digjnin pa më pyetur mua. Tani kam edhe unë një fjalë. Djemtë e tu në Shkodër,

1) rrokoll — bie duke u rrokullisur.

o Zenel, kanë shitur grurë kur isha unë në burg.  
ZENELI — Dyqind kuintalëve ua gjetëm vendin, po ç'c  
do, nuk mundëm të shesim më tepër se mos binim  
në sy.

BEQIRI — Pra, çdo gjë është e regjistruar?

ZENELI — Më vjen keq që ma bën një pyetje të tillë,  
Beqir aga.

BEQIRI — Zotnia yt të pyet. Gojët e këqia na marrshin  
të keqen. Tani kam edhe diçka tjetër, që vetëm  
juve e zotit në qiell ia them.

BUDJA — Mos ki merak, Beqir aga. Ti na njeh mirë.

BEQIRI — E kam fjalën për Halilin. Ai i di të gjitha.  
Kam frikë se na ngatërron ndonjë lëmsh e na tra-  
dhëton. Si thua ti, Bude?

BUDJA — Po ç'të them unë e mjera. Edhe mua më ka  
shkuar mendja sa herë tek ai.

BEQIRI — Është kriminel i ndyrë. Sikur ia lexoj në fy-  
tyrë mendimet që ka në kokë. Ia merr mendtë flo-  
riri atij. Duhet ta ruani patjetër, po pa i rënë në  
sy. Ju e dini se kjo punë tashmë nuk është vetëm  
e imja. Ç'njeri tjetër kam unë përveç jush! Djali  
humbi pas asaj kurve italiane. Siç kam dëgjuar  
është bërë edhe i krishterë për hatër të saj. Ai nuk  
sheh një kacidhe prej meje. Mos vallë do t'ia jap  
vajzës gjithë këtë pasuri? Nuk jam çmendur ta  
bëj një punë të tillë. Vajza do të marrë hisen e vet.  
Pra, ju e djemtë tuaj keni për ta gëzuar.

BUDJA — E pse na i thua të gjitha këto, Beqir aga?

BEQIRI — Që të hapni sytë e ta ruani mirë Halilin.

BUDJA — Atë e kemi vetë në kujdes.

BEQIRI — Tani shkoni e më sillni Halilin. Po shumë  
kujdes veç. (*Dalin*) Sa e tmerrshme qenka kur  
arrike të mos i besosh më as vetes. Jetë është kjo?  
Rri duke pritur kur po ta kërcasin e nga po të vjen.



Të gjithë kërkojnë të më grabisin, të më zhvatin. Kujtojnë se kam ngordhur dhe lëshohen si korbata mbi mua. Budja, Zeneli, Halili... E kujt t'i besoj prej këtyre? (*Hyn Halili vetëm*).

HALILI — Gëzohem që të shoh, Beqir aga! (*Përqafohen*).

BEQIRI — Ku të kam, Halil Nurja. Ti më dole djalë e përmbi djalë. Kur mendoj se të kam ty këtu më qetësohet shpirti. Je i fortë?

HALILI — Nuk na përkulin komunistët ne, o Beqir aga. Po ju andej si jeni!

BEQIRI — Shpresën e kemi të madhe kësaj here. Miqtë përtej detit diçka po përgatisin. Nuk e duron inglizi e Amerika komunizmin në Shqipëri.

HALILI — E pra, ne këtu urdhrat tuaja presim.

BEQIRI — E di që ti ke lindë për të komanduar. Të ishin të gjithë si ti nuk do të kalonim në këtë skëterrë që na sollën komunistët. Tani më thuaj si duken këta!

HALILI — Zeneli nuk duket keq, po Budja ma prishi ca qejfin

BEQIRI — Pse?

HALILI — Dha shenja se dyshon tek unë.

BEQIRI — Shiko, shiko, sigurisht do që të humbë gjurmë. Është një dhëlpër ajo! Ia kam shumë frikën. Ajo e tërheq për hunde Zenelin. Kam frikë se luan bishtin shtriga dhe na merr në qafë. Por as Zeneli nuk është më i mirë! Edhe ai gjithnjë ka kërkuar të peshkojë në ujë të trubullt. Jam i bindur se ata mendojnë natë e ditë si të na zhdukin mua dhe ty dhe ta marrin për vete të gjithë pasurinë. Bëmë gabim, Halil, që i morëm edhe ata, sidomos në fshehjen e teneqeve.

- HALILI — Si të të them! Megjithatë unë po dhe urdhër ti...
- BEQIRI — Nuk e ke keq ti jo, po kam frikë se po çojmë qentë peshë. Më mirë rrijmë e presim si po shkojnë punët e mandej shohim e bëjmë.
- ZENELI — *(Hyn shumë i shqetësuar)* Kujdes, kujdes!
- BEQIRI — Çfarë është?
- ZENELI — Më duket se po vjen kontroll!
- BEQIRI — Mos more, na fiku! Shpejt, Halil, në bodrum se na mori lumi. *(Zeneli ka larguar një arkë dhe ka hapur një hyrje në dysheme. Në oborr kanë hyrë një grup të rinjsh. Dëgjohet kënga e tyre: Pararoja, pararoja ju fashistë të fëlliqur ja ku vjen, pararoja, pararoja dhe ju vdekjen ju rrëfen, etj.)*
- HALILI — Jo, ore, se s'janë kontroll këta!
- BUDJA — *(Hyn)* Mos u shqetësoni, mos u shqetësoni Janë ata që këndonin në mëngjes. Kërkojnë karriqe se kanë konferencë. I largoj unë ata. U jap karriqet e ikin. Halili të fshihet se po vjen Selim Myrtja. *(Halilin e fusin në musandër, Zeneli del me Buden, hyn Selimi).*
- SELIMI — Selam aleqëm, Beqir aga.
- BEQIRI — Aleqëm selam. Hajde Selim, ulu! Po si je vetë, si i ke nga shtëpia?
- SELIMI — Mirë prej zotit.
- BEQIRI — Bëre ndonjë kokërr misër?
- SELIMI — Faqen e zezë, Beqir aga! Edhe atë që bëra e hëngra me partizanët. Nuk më teproi gjë për të larë hakun te Zeneli.
- BEQIRI — Lëre, ore hakun. Ti me partizanë e ke ngrënë. Fundi i fundit partizanët janë tanët. Luftuan



dhe na çliruan. Po na hëngrën mishin koskat na i lenë. Djaln në ushtri e ke?

SELIMI — Si urdhëron.

BEQIRI — Ti m'i ke pasë ngelë ca borxh.

SELIMI — Si urdhëron, po ja që...

BEQIRI — Nuk të kam thirrë për borxh, o Selim. Së pari të falem nderit që më ke ruajtur kullën e barit.

SELIMI — Nuk kam bërë ndonjë gjë të madhe. Çelësat kam mbajtur. (*Hyn Budja*)

BEQIRI — Pastaj ti e di se gruaja ime po vdes!

SELIMI — Jo more! Nuk di gjë.

BEQIRI — Ajo ka marrë fund, o Selim. Ti e di se kulla e barit, si dhe toka që punon bashkë me kaçorre, kanë qenë pasuri e saj!

SELIMI — Kështu kam pasë dëgjuar.

BEQIRI — (*Budes*) E di ti, o Bude, se ky Selimi paska qenë njeri me fat?

BUDJA — Epo njeri i mirë ka qenë gjithmonë, i shkretiti. I varfër por i ndershëm.

BEQIRI — Para se t'i merrej goja, Zylfie hanmi më thirri një ditë dhe më foli me lotë në sy. Ti, më tha, je sjellë shumë keq me Selim Myrton. Për natë më shtiret në ëndërr xhebraili dhe më thotë: «Falja kullën Selim Myrtos, ndryshe kurrë shpirti yt nuk do të ketë qetësi!»

BUDJA — Shiko, shiko! E lumja Zylfie hanëm për shpirt që ka. (*Fshin lotët*)

BEQIRI — Po nuk ia fale, më tha, edhe ty do të të gjejë ndonjë e keqe. Unë, të them të drejtën, i mora për tallje fjalët e saj. Ke parë ti, pas tri ditësh më futën në burg.

BUDJA — Shiko, shiko! Si më rrëqethet mishi!

BEQIRI — E çfarë nuk hoqa në atë qelbësirë burgu ku

ta pinin gjakun tartabiqet! Nejsë! Një natë më del edhe mua në ëndërr xhebraili e më thotë: — Hë, o Beqir, t'u mbush mendja? Aman, i thashë, të dal nga burgu pa ia kam falë Selimit kullën e barit me gjithë tokë e kaçorre, si dhe borxhët që më ka. Të nesërmen dola nga burgu.

SELIMI — Do të ma falësh mua kullën e barit, Beqir aga?

BEQIRI — Me gjithë tokë e kaçorre. Po çuditësh?

BUDJA — E si të mos çuditet, zoti Beqir!

SELIMI — Zylfie hanmi të më falë mua kullën e barit? Pastaj, ti sot je ngushtë për vete.

BEQIRI — Ke arsye. Unë sot jam ngushtë, por amanetin e gruas nuk e prish edhe sikur të më varin. Ka hyrë perëndia në mes, o Selim. E me perëndinë e xhebrailin nuk bëhet shaka. Pse rri si i shushatur?

SELIMI — Më duket sikur po talleni me mua.

BEQIRI — Ashtu? Ja pra edhe tapinë. Është në rregull me vula e me firma. E ka punuar Abdulla efendia. E gëzofsh me nipa e stërnipa. Unë e kisha barrë në shpirt nga gruaja këtë detyrë. Tani sikur m'u lehtësua shpirti.

BUDJA — Hë, si po të duket, o Selim?

SELIMI — Çuditëm si nuk çmendem.

BEQIRI — Ti po deshe rri e prit se të japin tokë edhe komunistët. Po kullën e barit dhe tokën rreth saj s'besoj të ta japin.

SELIMI — Atë hall qaj edhe unë, Beqir aga. Tani unë kam tokën, shtëpinë dhe kullën e barit. Kur të ndahen tokat më gjejnë në tokën time dhe nuk më luajnë vendit. Por...

BEQIRI — Çfarë?

SELIMI — Çfarë do të thonë të tjerët? Çfarë do të thotë Laja?



BEQIRI — Ç'punë ke me Lajen ti?

SELIMI — Kemi bërë krushqi. I kam dhënë vajzën për Manin.

BEQIRI — Kur paska ndodhë kjo?

SELIMI — Para tri ditësh.

BEQIRI — Kjo nuk po më pëlqen.

BUDJA — Unë nuk shoh ndonjë të keqe në këtë fejesë, Beqir aga. Selimit i qoftë për hajër. Ku e merr atë fat të kesh krushkë si Laja.

BEQIRI — Po ajo krushkë sa të marrë vesh se unë ia kam falë Selimit kullën patjetër vjen e na e merr barin për ushtrinë.

BUDJA — Po Selimi nuk ka për t'i treguar Lajes para se të largohet bari andej. Ne, o Selim, duam ta shesim barin për të larë borxhin e zotnisë. I kërkojnë edhe dy milionë të tjera.

ZENELI — *(Vjen prapë i shqetësuar.)* Kujdës, kujdës se po vjen Laja.

BEQIRI — Laja?

BUDJA — Po kjo ç'do? *(Zenelit)* Përcille Selimin në dhomën tjetër se mos e sheh Laja këtu.

ZENELI — Sikur mos ta presësh as ti, Beqir aga.

BUDJA — Jo, jo, ajo do ta ketë marrë vesh se ka ardhë prandaj vjen.

*(Del Zeneli me Selimin)*

BEQIRI — Edhe këtë e kishim mangut.

BUDJA — Kujdës dhe gjakftohtësi, Beqir aga. *(Del dhe pas pak hyn me Lajen. Me Lajen vijnë edhe dy fshatarë të armatosur)*

LAJA — Oho, Beqir aga! Kur na paske urdhëruar zotrote?

BUDJA — Tani sa arriti me karrocë se makinën ia morën.

LAJA — Gjynah, atë farë makine! Por edhe me karrocë nuk është keq. Të zu malli për këto anë, Beqir aga, apo jo?

BEQIRI — Nuk po na lënë hallet të përmallohemi, o Laje. Tani mua nuk më merr malli as të jem gjallë.

LAJA — Kaq shpejt u mërzite, Beqir aga?! E pra ky është fillimi!

BEQIRI — E di mirë. Një fshat që duket nuk ka nevojë për kallauz.

LAJA — Si e kam Zylfie hanmin. Më thanë se i ka rënë pika gojës.

BEQIRI — Ashtu është. Flet me gishta.

LAJA — Epo sa mallëkime ka ngrënë ajo prapë shumë i ka edhe gishtat.

BUDJA — Mos fol ashtu, o Laje, se është gjynah para zotit.

LAJA — Ti mos na u përziej në bisedë se jam duke folur me Beqir agën. Në burg ishe zotrote?

BEQIRI — Po, shkova për verim.

LAJA — E si e kalove verën?

BEQIRI — Shumë mirë. Uroj ta kalosh edhe ti ashtu.

LAJA — Unë kam kaluar denbabaden verime të tilla, kurse ti tani po e fillon. Nejsë! Mirë që të takova se kisha punë edhe me ty.

BEQIRI — Çfarë pune ke me mua?

LAJA — Jemi ca keq për bukë, Beqir aga.

BEQIRI — Ti keq për bukë?

LAJA — Jo, more unë! Populli! Duan të hanë njerëzia, ndryshe nuk punojnë dot. Unë e di se ti thua me vete: Akoma nuk kanë ngordhur të gjithë! Se mos punojnë për mua. Këtu ke plotësisht të drejtë. Ne të varfërit sot punojmë për vete. Duhet ndërtuar urat, rrugët, duhen ndërtuar shtëpitë e popullit që i dogji italianit dhe gjermanit. Kanë ngelë njerëzia jashtë.

BEQIRI — E pse m'i thua mua këto?



**LAJA** — Sepse jeni ju që po na pengoni. Drithin e fshihni. Florinjte i fusni tre pash nën dhe. Mallin e kalbni nëpër bodrume dhe i lini dyqanet bosh. Tatimet nuk i lani.

**BEQIRI** — E me çfarë t'i lajmë? Nuk na kanë ngelë tjetër veç morrat e burgut. Me mall të huaj nuk ndërtohet shtëpia. Ju vetë i dolët zot kësaj pune. Hajt pra, ndërtojeni Shqipërinë! Nuk ju pengon njeri. Ç'keni që na bini në qafë?

**LAJA** — Ju nuk na pengoni? Harruat si na luftuat dje?

**BEQIRI** — S'është e vërtetë. Ne tregtarët s'ju kemi luftuar. Po t'ju kishim luftuar si duhet nuk do të arrinim në këtë ditë halli dhe ti do t'i matje fjalët para meje.

**LAJA** — Të mos shkojmë larg, të rrijmë në Vulkaj: Xhemalin e Sulën kush i vrau?

**BEQIRI** — Mua mos më fut në të tilla kallëpe. Gjakun e tyre shko e kërkoje tjetërkund e jo tek unë.

**LAJA** — Unë nuk kërkoj gjak sipas zakonit të vjetër. Gjakun e tyre sot e kërkon populli se për të u vranë.

**BEQIRI** — Ç'të paska hipur gjithë ky vrer kundër meje, o Laje.

**LAJA** — Se të njoh mirë, o Beqir aga! Eh, ç'do ti!

**BUDJA** — E zeza! Le të të vijë pak turp, o Laje. A i fli-tet në këtë mënyrë një zotnie që deri dje e nde-ronte gjithë Shkodra.

**BEQIRI** — Nuk ma ka marrë mendja se Xhemal Mani paska rritë në shtëpinë e tij një kuçedër të tillë!

**LAJA** — E di! Kuçedër quan popullin ti që lufton kundër jush. E pra, kjo kuçedër do t'ua hajë kokën atyre që vranë Xhemal Manin, Sulën dhe çdo shok e shoqe tonën!

**BEQIRI** — Nuk ta kisha borxh të sillleshe në këtë mënyrë në shtëpinë time.

LAJA — Kjo shtëpi u shtetëzua. Këshilli ka vendosë të hapë këtu shkollën dhe të vendosë disa familje bujqish.

BUDJA — Qyqja, po ne?

LAJA — Po të doni ka dhoma në bodrum.

BUDJA — Në bodrum? Po jetohet në bodrum?

LAJA — Jetohet për bukuri. E ke parë kaçorren time? Mandej ne me zor nuk po të futim. Unë çuditëm, pse të rri në bodrum? Shkoni në Shkodër te djemtë. Ja vendimi, Beqir aga. I pafsh hajrin dhe i ndjefsh lezetin. Pra, siç e shikon, unë po sillem kë-shtu në shtëpinë time, në shtëpinë e popullit. Më përket se jam përfaqësuese e popullit.

BEQIRI — Kjo është grabitje ditën për diell. Me një pusullë bakalli të më merret një pallat i tërë. Unë do t'i paguaj dy milionët.

LAJA — Atë e di pushteti. Pastaj, po ta shikosh drejt, ti të kesh pallat veror me tetë dhoma, çardaqe e bota ta gdhijë jashtë, nuk vete fare.

BEQIRI — E kam vënë me djersë.

LAJA — Me djersën e gjumit të vapës. Më mirë mos t'i hapim këto deftere, Beqir aga. Kam edhe një çështje tjetër.

BEQIRI — Prapë?

LAJA — U mërzite? Keq, keq, Beqir aga. Të këshilloj ta marrësh më shtruar, ndryshe prish shëndetin. Siç mund ta marrësh me mend ushtria i ka kafshët pa ushqim. Pra, i duhet bari. Kjo është letra që e rekuizon barin e kullës. Asnjë deng bar nuk duhet të dalë andej.

ZENELI — E kur do të vijë ta marrin barin?

LAJA — Kur t'u duhet. Sigurisht, nuk do të vijë t'ju pyesin ju. Çelësat do t'i mbajë këshilli. Ti, Zenel, mos përto e m'i sill ata çelësa.



ZENELI — Unë nuk i mbaj çelësat.

LAJA — Po kush i mban?

BEQIRI — *(I vendosur)* I zoti i kullës.

LAJA — Nuk po kuptoj.

BEQIRI — Tregoja, Bude.

BUDJA — Ti, o Laje, e di se kulla e barit ishte e Zylfie hanmit?

LAJA — Po mandej?

BUDJA — Po si duket allahut iu dhimbs e gjora Zylfie. Para se t'i merrte gojën, tregon Beqir aga, ia çoi xhebrailin në gjumë te veshi dhe i tha tri net me radhë: Falja kullën e barit fukasasë.

LAJA — Edhe ajo sigurisht ia fali.

BEQIRI — Ç'ia tregon kaq gjatë, o Bude, se mos besojnë komunistët.

LAJA — Nuk ke faj, gjëra për t'u besuar janë! Po kujt ia fali?

BUDJA — Ia fali Selim Myrtos.

LAJA — Ashtu? Tani e mora vesh!

BUDJA — E pa zoti Selimin e shkretë se ka vuajtur gjithë jetën.

LAJA — Pra te Selimi i gjej çelësat?

BEQIRI — Te Selimi, te Selimi! *(Laja ngrihet e niset.)*  
Nuk po na thua as lamtumirë?

LAJA — Mos e harro Xhemalin e Sulën. Kjo është lam-  
tumira ime. *(Del)*

BUDJA — Pah, ç'nëpërkë! Kjo të përvëlon.

BEQIRI — Ja, të tillë janë këta djaj komunistësh kudo. Mjerë ne që arritëm të kemi punë me ta! *(Del Halili nga musandra.)*

HALILI — Nuk e di çfarë më ndaloi t'ia numëroja kokës. Unë them, Beqir aga, se duhen zhdukur si Laja si Mani. Më mirë t'i vras para se të na bëjnë varrin.

BEQIRI — Prit, më lini të përmblihem. Djalli ta marrë, tym më nxjerr koka.

BUDJA — E mjera unë që të shoh në këtë hall!

BEQIRI — Si thua ti, Zenel.

ZENELI — Po e largoi ushtria barin zbulohet drithi. Mua dhe zotrote burgu na pret.

BEQIRI — E ti si thua, o Halil!

HALILI — Është koha të merret një vendim, Beqir aga. Thërras shokët unë. Për dy ditë i ke këtu. Vrasim Lajen e Manin, djegim kullën e barit, djegim drithin dhe malli në bodrum shpëton.

BEQIRI — Si thua, ti Bude.

BUDJA — Po të vritet Laja me Manin, pas kësaj që ndodhi këtu, kam frikë se e kapin zotninë tënde. E po të kapën ti e di se çfarë të gjen. Unë mendoj që kulla e barit; fundi i fundit le të digjet kurse ata të dy të lihen për më vonë.

BEQIRI — Mirë e ka Budja. *(Turbullohet)*

BUDJA — Beqir aga, Beqir aga. E zeza!

ZENELI — Çfarë ke, Beqir aga.

BEQIRI — S'kam gjë. Më kaloi. E ndiej veten të këputur.

BUDJA — E si të mos këputesh, o i zi, megjithato që po të bien përmbi kokë. *(E kap për krahu.)* Eja, eja të shtrihesh.

BEQIRI — Ti, Halil, eja pak.

ZENELI — Po karroca, Beqir aga? Ajo po pret poshtë.

BEQIRI — I thuaj të niset. Unë do të qëndroj këtu son-te. Mos u trazo, Bude, shkoj vetë të shtrihem. Eja, Halil! *(Del bashkë me Halilin.)*

ZENELI — Prapë po bisedojnë bashkë tinës nesh: Bude, ata janë çmendur. Po ta djegin kullën e barit mbaruam. Na shkojnë kokat edhe pasuria.

BUDJA — Mos u shqetëso. U ka ra në mend vonë. Tani



le të bëjnë ç'të duan. Syrit dhe veshëve tanë nuk u shpëton asgjë. (Pauzë) Me të vërtetë që janë çmendë! Duan të djegin kullën e barit. Jo, Beqiri aga, nuk jemi aq budallenj sa të lëmë kokat për ty. Kulla e barit nuk do të digjet. Ajo më duhet shumë tani që po filloj lojën time.

ZENELI — Çfarë loje?

BUDJA — Lojën time të bixhozhit me komunisten Laje.  
Të shohim kush do të fitojë në këtë mes.

## PJESA E DYTË

### Tabloja e tretë

*Shtëpia e Selim Myrtos. Dhomë fshatare e varfër  
por e pastër.*

SELIMI — (Po përgatitet të dalë) Tani dëgjoni ju të  
dyja këtu! (Havasë). Ty po të flas, moj dreq!

HAVAJA — Edhe unë po të dëgjoj, o burrë.

SELIMI — Vajza nuk ka punë jashtë pragut të derës.

HAVAJA — Qyqja, pse?

SELIMI — Të plastë koka, të plastë! Se është e fejuar.

LULJA — Po unë kam punë, baba.

SELIMI — Punë ke në shtëpi sa të pëlçasësh.

LULJA — Kam punë të Lëvizjes, punë me shokë, me

Lajen.

SELIMI — Dëgjo, t'i këpus të dy këmbët po të pashë  
më me Manin. E po e gjeta Manin këtu, e prish

fejësën.

HAVAJA — E zeza! Ç'janë këto fjale, o burrë! Çfarë  
paske sot kështu, sikur të kanë ndërruar xhindët!

LULJA — Sigurisht ia ka ngatërruar mendjen Begir aga.

SELIMI — Shiko, të thyej turinjtë unë.

HAVAJA — Dale, more burrë. Ç'është kjo sjellje?

SELIMI — Lëvizjen e ke këtu, në shtëpi.

LULJA — Po Laja më ka ngarkuar me punë, baba!



SELIMI — Lajes mos ia tirrni gjatë bisedën!

HAVAJA — Ky s'është në vete! Ne e kemi krushkë, more burrë!

SELIMI — Moj, mua do të ma tregosh?!

HAVAJA — E pra, mbli dhe mendjen atëherë. Si flet kështu?

SELIMI — Në këtë shtëpi do të bëhet ashtu siç them unë. More vesh? *(Del.)*

HAVAJA — U këmbye burri.

LULJA — Që kur u takua me Beqir agën. Sigurisht ai ia ka mbushur mendjen. Beqir aga nuk i shikon dot me sy as Lajen as Manin.

HAVAJA — Po me ne ç'punë ka!

LULJA — Ka me babën. Tani i duhet Selim Myrtja atij. Kushedi në çfarë kurthesh do ta përziej.

HAVAJA — Po ti do të takohesh me Manin?

LULJA — Si jo! Edhe sikur ta më bëjnë trupin copë. Kam dy ditë pa e parë. Çuditëm si ka ngelë pa ardhë deri tani. *(Hapet dera e duket Mani.)*

HAVAJA — Po ti, mor i zi!

MANI — Nuk qenka Laja këtu?

LULJA — Jo, pse?

MANI — Ajo më tha se do të vinte këtu. Kishte punë me Selimin. Po ju çfarë paskeni kështu?

LULJA — E takove babën?

MANI — Jo. Pse më shikoni kështu? Çfarë ka ndodhë?

LULJA — Baba nuk do që ne të takohemi më.

MANI — Pse?

LULJA — Gjoja jemi të fejuar! Ashtu thotë po nuk tregon se ku e ka hallin.

HAVAJA — Nuk po marrim vesh se çfarë ndodhë kështu me të.

LULJA — Po ta shoh Manin në shtëpi, tha, e prish fejesën.

MANI — E qartë. I mban krahun Beqir agës për hatër të kullës së barit.

HAVAJA — Ç'kullë bari, o Man?

MANI — Pse, nuk dini gjë ju?

HAVAJA — Jo, ai e ka kyçur gojën e nuk flet.

MANI — Beqir aga ia ka falë Selim Myrtos kullën e barit. Dhe Selim Myrtja e ka pranuar duke e falenderuar. Pra, Beqir aga i dha dorën që t'i hajë kokën. Nuk e di Selimi se Beqiri nuk të jep gur të çash kokën e jo një goxha kullë bari.

LULJA — Ja ku i doli koka, o nënë.

MANI — Ia fali tani që e di se do t'i merret.

HAVAJA — Po na e prishin qetësinë. Ne presim të marrim tokë nga qeveria. Nuk na duhet gjë kulla e barit që na e fal Beqir aga. Larg peshqesheve të tij. Kafshata e madhe të zë fythin. S'e kam as Rakiptin këtu se ai nuk do ta linte të atin të binte në një grackë të tillë.

MANI — Sa për atë mos u mërzit, o nënë Hava. Ke Lajen, ke mua.

HAVAJA — Mandej kam frikë se të gjen edhe ty këtu e, nga tërbimi që ka marrë, shfren përmbi vajzën.

MANI — Po unë çfarë bëj këtu? Jo, ore, se s'e lë unë! Selimin e nderoj si vjehërr po nuk duroj t'i bjerë as qimja Lules për hesap të Beqir agës dhe të kullëve.

HAVAJA — E lumja unë sa fort e doni njëri-tjetrin!

MANI — (Lules) Po vuri dorë mbi ty ik e eja tek unë.

LULJA — Jo, Man, nuk dua të ndahem në këtë mënyrë me të. Pastaj, ashtu merr zjarr ai, por përsëri bie. (Havaja del për punë.) Man, punët po ngatërrohen. Informata që i dhashë sot Lajes po vërtetohet. Dje, që më foli Sabria, vajta kastile në kullë dhe vërejta se dysHEMEJA e saj ishte me të vërtetë prej



çimentoje ashtu siç më tha ajo. Pra, bodrumi i Beqir agës patjetër mban pasuri të madhe përbrenda ashtu si thotë Sabria.

MANI — S'do mend. Prandaj zotnitë e Shkodrës ia fallin kullën e barit Selim Myrtos.

LULJA — Kam frikë se do t'ia bëjnë ndonjë të zezë babës.

MANI — As mos u mërzit fare për atë punë. Janë marrë të gjitha masat. Laja lajmëroi atje ku duhet. Veç kësaj unë zbulova me anën e një miku nga Bahçellëku se në kullë janë fshehur pesëqind kuintalë drithë. Ai miku m'u betua se pak ditë para se të çlirohej Shkodra kishte mbajtur në krah drithin që shkarkonin kamionat.

LULJA — Ia the Lajes këtë.

MANI — Ia thashë dhe ajo e nisi ku duhet. Po ti, Lule, si ia nxore nënë Sabries një gjë të tillë. Ajo sikur e kishte mirë me ata. Budja thoshte që e ndihmoi Sabrien se rrit jetimët.

LULJA — Ashtu thoshte Budja, po po të dëgjoje Sabrien të ngjethej mishi. Ajo e kishte futur në borxhe deri në fyt. I kërkonte lopën, i thoshte të shiste tokën dhe të lante borxhet. Kur e binda se nuk duhej t'i paguante asnjë grosh Zenel Danit nisi t'i qeshë fytyra dhe e zgjidhi gojën. Të bijtë dhe e bija kur e morën vesh këtë gjë u zemëruan kundër nënës, që nuk kishte folur më parë. (*Duket Laja në derë. Mbrapa është Havaja*) Ja, erdhi Laja.

LAJA — Po ti, o trim, këtu na paske ardhë? Burrat e vërtetë nuk venë pas fustaneve të grave.

HAVAJA — Hajde, urdhëro, o Laje.

LAJA — Mos i merrni për të vërteta sharjet që i bëjnë unë Manit. Mbrëmë ai ishte me ndjekjen. I qëruan dy kriminelë dhe dy të tjerë i zunë gjallë.

LULJA — Atje ishe ti, Man?

LAJA — Atje ishte dhe luftoi mirë. Është trim dreqi!  
Po ma prish pak se vete shumë pas Lules.

HAVAJA — E duan njëri-tjetrin, o Laje. Të bëhet zemra mal kur i shikon. Po ç'e do, nuk po i lënë të qetë.

LAJA — Kush?

HAVAJA — Selimi. Nuk e di se çfarë e gjet.

LAJA — Shiko, shiko! S'ka gjë se ia ndreq unë samarin atij. Ku është Selimi se për të erdha?

HAVAJA — Te kulla e barit.

LAJA — Ajo kullë ia mori mendjen atij. (Manit.) Ti kishe gjë punë me mua?

MANI — Kisha këto shkresa për këshillin. Pastaj... (Shikon Havanë. Ajo largohet. Shikon edhe Lulen).

LAJA — Fol, fol. Lulja është jona.

MANI — Kam këtë letër shumë sekrete nga shoku Stavri.

LAJA — (E hap dhe e lexon) Posi! posi!

MANI — Çfarë?

LAJA — Kujdes, bijtë e mi!

LULJA — Çfarë ka ndodhë, Laje?

LAJA — (Vendos ta lexojë letrën) Sonte ose nesër mbrëma reaksioni do ta djegë kullën e barit. Informata është e sigurtë. Të vish menjëherë për koordinim...

MANI — Shiko, shiko!

LAJA — A janë lajmëruar të gjithë?

MANI — Të gjithë në gatishmëri. Vetëm urdhrin presin.

LAJA — Na duhen çelësat e kullës patjetër.

LULJA — I ka baba me vete.

LAJA — (Manit.) Tani të shkosh e të ma sjellësh Selimin këtu. I thuaj të thërret kryetarja e këshillit të vish patjetër dhe menjëherë.



LULJA — Të vete edhe unë?

LAJA — Jo, ti rri këtu. (*Mani del. Laja sillet nëpër dhomë, pastaj ulet.*) Do të të jap një pusullë ta shpiesh tani në Kuqan. Është sekret dhe shumë me rëndësi. Shkon me kokë. Pra, e shpie?

LULJA — E shpie.

LAJA — Ja dhe armën ta kesh për mbrojtje.

LULJA — Nuk kam nevojë. Kam timen. (*Nxjerr berretën që i ka falur Mani.*) Ma ka falë Mani.

LAJA — (*E përqafton.*) Të pastë Laja! (*Ulet të shkruaj. Hyn Havaja.*)

HAVAJA — Po vjen Budja.

LAJA — Çfarë, çfarë?

HAVAJA — Budja vetë po vjen.

LAJA — Shenjë e mirë. Po përulen. Po, po! Po përulen.

LULJA — Pse vjen ajo, o Laje.

LAJA — Pse i ka shtërnguar keq laku ynë. Kushedi ç'lëmsh kërkojnë të ngatërrojnë veç të dalin nga laku. Asnjë arsye tjetër s'e përul Buden kaq tepër sa të vijë e të më kërkojë mua. (*Troket dera.*) Hape!

BUDJA — Po çuditëni?

HAVAJA — Sigurisht që po çuditëm. Ti nuk më ke shkelë ndonjëherë në derë.

BUDJA — Edhe kësaj here nuk erdha për ty, o Hava! Qofshi mirë!

HAVAJA — Mirë se erdhe! Hajde, urdhëro!

BUDJA — Si je, o Hava?

HAVAJA — Mirë prej zotit!

LAJA — Po ti ç'deshe këtu?

BUDJA — Ty po të kërkoja, o Laje. Isha nga shtëpia dhe e gjeta derën mbyllë. Takova Manin në rrugë. Ai më drejtoi këtu.

LAJA — Çfarë pune paske me mua.

BUDJA — Dale të marr frymë njëherë.

LAJA — Fol se nuk kam nge të merrem shumë me ty.

BUDJA — Kësaj here besoj se e vlen barra qiranë të merresh ca me mua. Pra është mirë mos të ngutemi. Ti e di se biseda nuk i përngjan bisedës. Mandej disa punë duan vendin dhe kohën e tyre pasi disa fjalë nuk mund të thuhesh kudo.

LAJA — Hava, dil pak përjashta. (*Havaja del*).

BUDJA — Ja sa mirë që filluam të kuptohemi.

LULJA — Të dal edhe unë?

BUDJA — Shumë mirë fole, të pastë Budja. Kot nuk kam thënë unë se Havaja e ka shumë të zgjuar këtë vajzë. Dil edhe ti. (*Lulja del, Budja i vë rezen derës*) Tani mund të flasim.

LAJA — Atëherë?

BUDJA — Prit, o Laje, se nuk është e lehtë. Hapa bëjmë përditë. Po jeta e sjell nganjëherë që duhet të matesh mirë kur e hedh hapin. Një hap gabim, e thyen qafën.

LAJA — E pse erdhe atëherë, për të thyer qafën?

BUDJA — Unë nuk vi me atë qëllim, po ku i dihet?

LAJA — Fol më qartë.

BUDJA — Unë e di, o Laje, se ti nuk më beson. Dhe ke plotësisht të drejtë. Në saje të Beqir agës kemi jetuar mirë deri tani. Edhe djemtë në Shkodër me ndihmën e tij e kapën veten. Zeneli, si kujdestar i tokave dhe i pasurisë së zotnisë nëpër katunde, nuk e ka çuar keq. Po tani Beqir agën po e merr lumi teposhtë përditë. A është e drejtë të vemi edhe ne pas tij?

LAJA — Po e braktisni Beqir agën?

BUDJA — Po jeta është llogari, o Laje.

LAJA — Pra po e nxirrni në ankand.

BUDJA — Merre si të duash.



LAJA — E sa jepni për të?

BUDJA — Aq sa nuk jua merr mendja!

LAJA — Çudi! E pse kështu?

BUDJA — Pse nuk na e mban më ta ndjekim në punët e tij të çmendura. Fundi i fundit le t'i dalë zot ai bashkë me miqtë e tij këtyre punëve. Ne nuk e duam rrugën e tij se ajo na shpie me siguri në humnerë.

LAJA — Fol më shkoqur.

BUDJA — Është çështje koke këtu, o Laje! E kjo e shkretë kokë po të iku një herë nuk vjen më. Ç'kusur kemi ne të kërcejmë vallen e Beqir agës kur ai kërkon të mbrojë pasurinë e vet me kokat tona? Ç'kusur kemi ne se ai po çmendet dita-ditës. Nuk e di nga t'ia filloj. Mendoj se Zeneli ka nevojë për përkrahjen tënde.

LAJA — Unë të përkrah Zenelin?

BUDJA — Po, o Laje, duhet ta përkrahësh se nga kjo përkrahje varet koka e tij.

LAJA — Po punë e madhe!

BUDJA — Mirëpo koka e tij është e lidhur me kokën tënde dhe të Manit. Më fal se harrova edhe kokën e Selim Myrtos.

LAJA — Shiko, më fol qartë e mos më eja rrotull si kali në lëmë.

BUDJA — E fejove Manin?

LAJA — E fejova.

BUDJA — Me Lulen, vajzën e Selim Myrtos. I qoftë për hajër e të trashëgohen. E mori vesh edhe Beqir aga këtë fejesë dhe u gëzua shumë. Bile nga gëzimi i fali Selimit kullën e barit që ta gëzojë ndonjë ditë. Mandej Selimi do t'ia shpërblejë zotnisë të mirën me kokën e tij. Edhe pse është kokë qerose prapë Beqirit i hyn në punë.

LAJA — (*Zemërohet*) Fol, moj dreq!

BUDJA — Mos m'u kërcëno, o Laje. Rri e dëgjo e mos ma pre fillin e bisedës. Ku e kisha fjalën? Ah, po! Të lajmëroj se si ti si Mani e keni kokën në gërshërë.

LAJA — Nga kush?

BUDJA — Nga ai që të vrau babën dhe të zuri tët vëlla, Sulën, nga Halil Nurja.

LAJA — Ku e di ti.

BUDJA — Kur u bisedua kjo çështje isha aty.

LAJA — Kush e bisedoi?

BUDJA — Beqiri, Halili, Zeneli dhe unë. Unë ngula këmbë të hiqnin dorë nga vrasja juaj pasi mund të dyshohej Beqiri dhe të kapej. Edhe Beqiri u bind në sy tonë. Tinës meje dhe Zenelit ai e kishte urdhëruar përsëri Halilin që t'ju vrasë. Unë ia nxora me grep Halilit të gjitha çfarë kishin folë dhe erdha këtu. Ja pra pse s'ia kemi ngenë punëve të çmendura të Beqir agës.

LAJA — Po pse bisedoi Beqiri me Halilin tinës jush?

BUDJA — Pse ai e ka humbur besimin, sidomos tek unë. Ma tha copë Halili.

LAJA — Ku e ka strofullën Halili?

BUDJA — Brenda në një gropë, në bodrum të pallatit.

LAJA — Aty është gjithnjë?

BUDJA — Aty! (*Laja ngrihet të dalë*) Dale, mos u ngut. Nuk keni ndonjë rrezik hëpërhë.

LAJA — Çfarë do të më thuash tjetër?

BUDJA — Kur nis rrokullisja njerëzit e humbasin gjykimin. E more vesh çfarë përralle kishte kurdisur Beqir aga kur ia fali Selim Myrtos kullën e barit? Sikur bota hanë bar.

LAJA — E pse e bëri një punë të tillë?

BUDJA — Kërkon të kapet si i mbyturi nëpër shkumë



të detit. Fundi i fundit çfarë i kushton koka e Selimit qëllimeve të tij?

LAJA — Asnjë kacidhe.

BUDJA — Ashtu si nuk i kushton as koka jonë. Ashtu si nuk i kushtoi as koka e Xhemal Mani.

LAJA — Pra ai e vrau Xhemalin?

BUDJA — Ai, po kush tjetër? Ai vrau Xhemalin dhe zhduku Sulën. Me urdhër të tij Halili ia dorëzoi Sulën gjermanëve dhe ata e pushkatuan në Fushë të Shtoit. Ka qenë Halili aty kur e kanë pushkatuar.

LAJA — E di, e kam dëgjuar edhe unë. Po pse i bëri të gjitha këto?

BUDJA — Se shtëpia juaj ishte bërë qendër partizane. Beqiri nuk i honepste dot të varfërit kur merreshin me politikë. Mandej Xhemali nisi t'i vijë rrotull kullës së barit kur aty shkarkoheshin thasë me drithë. E këtë Xhemali e bënte, sigurisht, pse ishte i shtyrë nga Sula dhe partizanët.

LAJA — Ma hante mendja, megjithatë prapë më mirë që e dëgjova nga goja jote.

BUDJA — Po të largohen andej dengjet e barit dalin jo më pak se treqind thasë me drithë.

LAJA — Mos e ke gabim, o Bude?

BUDJA — Pse?

LAJA — Më duket se janë pesëqind.

BUDJA — E zeza! Nga e di ti këtë?

LAJA — Po ndonjë gjë e dimë edhe ne, o Bude. Çfarë ke? Pse u turbullove?

BUDJA — Nuk e marr vesh nga mund të ketë dalë kjo fjalë!

LAJA — Po edhe treqind po të jenë nuk na prish punë, o Bude.

BUDJA — Me të vërtetë ishin pesëqind por dyqind i shitën djemtë e mi në Shkodër.

LAJA — Ja pra si na paska qenë!

BUDJA — Po që do të digjet kulla e barit, mos e dini edhe këtë?

LAJA — Kulla e barit do të digjet? Mos u çmend Beqir aga?

BUDJA — Jo, nuk u çmend.

LAJA — Ç'interes ka ai të djegë kullën e barit. Atëherë pse ia fali Selimit kullën? Vërtetë kulla u rekuizua por po t'i ketë Selimi në rregull dokumentet pushteti nuk mund të vejë dorë në të. Nuk e di Beqiri këtë?

BUDJA — Ta thashë edhe përpara. Beqiri është çmendur fare. Selimit ai ia fali kullën vetëm për ta përdorur si mashë. Nesër mbrëma do të vijnë miqtë e Halilit të armatosur dhe do të djegin kullën e barit. Kur do të dilni ju për të shuar zjarrin, do t'ju vrasë Halili nga dritarja qorre e bodrumit ose do t'ju zënë pritë te dera. Nuk do të merret vesh vrasja juaj se do të duken pushkë të shtëna për kushtrim. Besoj se e shita mjaft shtrenjtë Beqir agën, apo jo, o Laje?

LAJA — Si të them, po prapë një gjë nuk ma shkoqite drejt sa të më bindësh.

BUDJA — Çfarë?!

LAJA — Ç'të shtyu ty që ta shesësh Beqir agën në këtë mënyrë?

BUDJA — Unë, pra, ta thashë qartë. Nuk i besojmë më njeri-tjetrit. E keqja është se ai e ka nuhatur një gjë të tillë. Sigurisht, Zeneli do t'i ketë dhënë shkas dyshimit. Beqiri është dhelpër plakë. Pra ashtu si e thuri vrasjen tuaj tinës nesh ashtu mund të thurë edhe vrasjen time dhe të Zenelit.

LAJA — E pse ta thurë vrasjen tuaj?

BUDJA — Se ai sot ka frikë hijen e vet e nuk i beson



as këmishës që ka veshë. Ai dyshon edhe te Hali-li. Këtë na e ka thënë copë mua dhe Zenelit.

**LAJA** — E për treqind kuintalë drithë t'i bëjë të gjitha këto Beqir aga? Nuk më mbushet mendja, o Bude. Më duket se Beqir aga kushton më shtrenjtë.

**BUDJA** — E shoh se nuk je tregtare e keqe. Ku e mësove këtë shkollë kaq bukur, o Laje. Nuk të mjafton që të shpëtova kokën ty dhe Manit. Nuk të mjaftojnë treqind kuintalë drithë?

**LAJA** — Komunistët nuk bëjnë pazarllëqe, o Bude. Por, pasi ia hyre kësaj pune çojë deri në fund!

**BUDJA** — E pandehja veten shumë të zonjën për punë të tilla por e shoh se ti ma kaloke. Të qërojmë hajdutët që do të vijnë të djegin kullën e barit pas-taj Budja ka për detyrë të paguajë edhe këstin tjetër.

**LAJA** — E sa peshon ky kësti tjetër?

**BUDJA** — Sa nuk ka kandar që e merr. Më lërë, djall, se m'i nxore të gjitha. Këtë këstin e fundit e kisha ruajtur si peshqesh që do t'jua jepja për t'ju bindur se po i japim shqelmin Beqir agës dhe po vijnë me ju.

**LAJA** — Prapë nuk ma shkoqite këstin tjetër.

**BUDJA** — Kulla e barit ka bodrum çimentoje pa derë. Unë e di hyrjen. Çfarë ka atje do ta çmoni vetë kur ta shikoni me sy. Pra mos harro, nesër mbrëma në mesnatë do të vijnë të arraturit te kulla e barit. Selim Myrtja do të vritet duke mbrojtur kullën, në mënyrë që mos të dyshojë kush se ka shtirë Beqiri njerëz për ta djegur kullën. Pra, Selimi do të vejë për dhjamë qeni. Ju e bëtë krushk Selimin e sigurisht do ta shpëtoni. Po mos harroni se po nuk shkoi Selimi të ruajë kullën e barit nesër mbrëma vihet në rrezik çdo gjë. Si të vritet

Selimi do t'i dalë flaka kullës së barit. Kështu e kanë vendosur.

LAJA — Po Beqir aga?

BUDJA — Beqiri tha se nesër pasdreke do të vejë në Kuqan e prej andej do të shikojë flakën e kullës. Por unë jam e bindur se ai do të vijë drejt e këtu... Tani besoj se e kreve detyrën ndaj jush.

LAJA — Po, dhe të jesh e qetë. Ne do ta kemi gjithnjë parasysh këtë shërbim që po na bën.

BUDJA — Këtë desha nga ti. Duam të jetojmë në qetësi. Le ta marrin kokës ata që e meritojnë. Asnjëri nuk duhet ta dijë që unë isha këtu. Po e mori vesh Halili ose Beqiri çdo gjë mbaron. Porosite Manin e sidomos Havanë. Asaj i llap goja.

LAJA — Për atë mos u bëj merak.

BUDJA — Lamtumirë, Laje, e dalshim faqebardhë!  
(Del)

LAJA — E çfarë na shite, moj zgjebe, ~~drithin, mallin apo djegien e kullës?~~

LULJA — (Hyn) Po kjo?

LAJA — Erdhi të na tregojë se kulla ka drithë dhe nën bodrum ka mall të Beqir agës.

LULJA — Po ne këtë e dinim.

LAJA — Na tregoi edhe se do të digjet kulla e barit.

LULJA — Pse s'i the se ka ardhë vonë?

LAJA — Në asnjë mënyrë. Duhet ta lëmë të veprojë.

LULJA — A tregoi pse e bënte një gjë të tillë?

LAJA — Ajo thotë se e bën nga tmerri që i ka hyrë. Kjo është e vërtetë. Ajo e di çfarë e gjen po të djegin kullën e barit, prandaj e shesin Beqir agën që të shpëtojnë lëkurën. Filloi shqepja e tyre. Erdhi koha që t'ia hanë kokën njëri-tjetrit. Por unë jam e bindur se Budja me Zenelin na fshehin diçka të madhe. Ia ndjej erën qelbësirës. Shiko, të



pastë Laja, do të të ngarkoj me një punë me shumë rëndësi.

LULJA — E di, të çoj letrën në Kuqan.

LAJA — Jo, do të veprojmë ndryshe. Mund ta ndjekësh Buden?

LULJA — Si ta ndjek?

LAJA — Mos t'i ndahesh, por ajo për asnjë çast nuk duhet të kuptojë se ti po e ndjek.

LULJA — Të thërras shoqet?

LAJA — Jo, jo se bini në sy. Do të shikosh kush hyn e kush del në pallat. Sonte edhe natën do ta kaloj duke vërejtur. Nisu. (*Lulja duke dalë takohet me Manin.*)

MANI — Ku po shkon Lulja?

LAJA — Lëre se ka punë. Hajde edhe ti këtu.

MANI — Çfarë ka ndodhë?

LAJA — Do të nisesh menjëherë për Bahçellëk. Do të të jap një pusull për komandant Stavrin. (*Ulet të shkruajë dhe e lë përgjysmë*) Jo, më mirë i thuaj me gojë: Plani duhet ndryshuar. Kanë dalë ca gjëra të reja. Takohemi në bazën numër një, ora dy pasdreke. Kupton?

MANI — Po a nuk bën të di diçka më tepër?

LAJA — Kur të kthehesh lajmëro bujqit Sadik Bejto dhe Islam Seferi të jenë sonte patjetër në shtëpinë time.

MANI — Atëherë u dashka të mbledh edhe unë të rinjtë.

LAJA — Ik, ore, atje ku të thonë. Dale, dale, ku shkon. Mos kalo nga dritarja qorre e bodrumit.

MANI — Pse?

LAJA — Të vret edhe ty Halil Nurja si tët atë.

MANI — Çfarë, çfarë?

LAJA — Rri, mos m'u krekos si kaposh.

MANI — Unë po e lyp për qiell!

LAJA — Mos na ngatërro, more, punë po të them.

MANI — (*I emocionuar*) Më ka vrrarë babën, më ka vrrarë vëllanë.

LAJA — (*E prekur*) Shko, të pastë Laja, kryej detyrën. Atij i ka ardhë sahati. Nuk na shpëton kurrësesi kësaj here.

MANI — Po Lulen ku e çove?

LAJA — Nuk ta gjen gjë Lulen, mos ki frikë. Ta ruaj unë.

MANI — Pse ta ruash ti? E ruaj unë.

LAJA — Shih, shih! Ik, ore, se ia arriti Selim Myrtja e po të kap në dru. Hajde, o Selim, se ty po të pres. (*Mani del, hyn Selimi*).

SELIMI — Po ky çfarë deshte këtu?

LAJA — Kishte punë me mua. Po si je, o Selim?

SELIMI — Moj, fol pse më thirre? Nuk kam nge për muhabete të gjata unë.

LAJA — Nuk ke faj. Ke lënë kullën e barit vetëm.

SELIMI — Ajo është punë për mua.

LAJA — More, mos je penduar që e fejove Lulen me Manin?

SELIMI — Jam penduar edhe shumë bile. Apo nuk kam arsye. I pata thënë gruas së drejt mos ta shoh Manin në shtëpi.

LAJA — Pse kështu, o Selim?

SELIMI — Pse kemi nder e namuz. Ku është parë t'i vijë i fejuari vajzës e të hyjë e të dalë si në shtëpi të vet. I thonë fshat këtu. Të venë teneqenë njerëzia. E unë nuk e duroj teneqenë.

LAJA — E di ç'bëjmë, e bisedojmë më vonë këtë çështje. Unë në të vërtetë nuk erdha për këtë. Unë erdha për çelësat.

SELIMI — Çfarë çelësash?



LAJA — Për çelësat e kullës së barit. A përton të m'i japësh?

SELIMI — Të të jap çelësat e kullës? Po pse?

LAJA — Ja urdhëri i komandës ushtarake. Bari i kullës rekuizohet dhe çelësat e kullës i kalojnë komandës.

SELIMI — E ç'punë ka komanda me kullën time?

LAJA — Atë e di tjetërkush.

SELIMI — Si u jepkan çelësat kështu?

LAJA — Nxirr çelësat po të them se të vë hekurat. *H. 20/3*

SELIMI — Si, ore, hekurat?

LAJA — Hekurat dhe i ke pak bile. Ku e more kullën e barit ti? Kush ta la, yt atë?

SELIMI — Nuk ia vodha kujt. E kam me tapi në rregull.

LAJA — Ku e ke tapinë?

SELIMI — Ja ku e kam. E ka shkruar Abdulla efendia me dorën e vet. E kam pyetur e më ka thënë se nuk e luan topi.

LAJA — Këtë s'e luan topi? *(Ia shqyen dhe ia hedh turinjve)*. Ja, tapinë!

SELIMI — Ç'bëre kështu, moj dreq! Si guxon të më pri-shësh shtëpinë! *(Do të nxjerrë thikën. Laja i vë revolen)*

LAJA — Shiko, shiko, Selim Myrtja do të vrasë kryetaren ë këshillit! E di, o i zi, çfarë do të thotë kjo? Hidhe thikën përtokë! *(Selimi e hedh thikën)* Për kokë të Manit, mos të ishe bujk do të t'i veja hekurat.

SELIMI — Ti, ti më more në qafë!

LAJA — Ti të ruash pasurinë e Beqir agës që të mos ia marrë pushteti! Turp të kesh!

SELIMI — Unë, unë ruaj pasurinë e Beqir agës?

LAJA — Ti, po kush tjetër! Silli çelësat e kullës.

SELIMI — Mjaft, mjaft u rropa gjithë jetën!

LAJA — Silli këtu po të them!

SELIMI — Desha të shikoj edhe unë një ditë. Tani që po ndahen tokat desha të marr tokën time dhe me këtë rast të marr edhe kullën e barit që gjëndet në të. Po ja, ti po m'i heq dore. Më erdhi fati te dera, ti po ma largon.

LAJA — Fati i kokës sate.

SELIMI — Ja, merri çelësat. Tani ma merr edhe shpirtin po deshe.

LAJA — Shpirtin nuk do të ta marr unë por do të ta marrë ai që të fali kullën e barit. Tani përmbli dhe veten e bëju burrë. Përgjigju pyetjeve të mia një nga një dhe shkoqur. Të kanë thënë të ruash kullën e barit nesër mbrëma?

SELIMI — Ku e di ti?

LAJA — Të kanë thënë apo jo! Përgjigju!

SELIMI — Po, më kanë thënë.

LAJA — Beqir aga të tha?

SELIMI — Beqiri vetë. Do të vij në makinat, tha, e do të marrin barin. Kështu do të më lirojnë kullën.

LAJA — Do të ta lirojnë që të të pëlcastin sytë e ballit. Do të vij në miqtë e Halil Nures dhe të parën punë që do të bëjnë do të të vrasin ty.

SELIMI — Mua? Pse?

LAJA — Pse i duhet ajo koka jote edhe pse është pa flokë. Ata vij në të djegin kullën e barit se ajo ka treqind kuinalë drithë nën dengjet e sanës. Të marr të mortja, të marr të! Ta tha Beqir aga këtë? Sigurisht nuk ta tha se nuk është i çmendur si ti. Ja pra po ta them unë, unë që po të prishkam shtëpinë dhe po të hiqkam fatin nga dora. Unë po të tregoj se ti do të vritesh nesër mbrëma për të vërtetuar se Beqir aga kishte lënë roje te kulla e ba-



rit e se ai gjoja nuk kishte gisht në djegien e saj. Pra, koka jote për Beqir agën kushton sa ajo paçavure që të hodha unë turinjve. Ti do të shkosh për dhjamë qeni. E ti e meriton një gjë të tillë se akoma nuk po bindet ajo koka jote. Si besove, o të rëntë pika, se Beqir aga po të fal kullën e barit? Si mendove se po shpëton ti nëpër dorë të atij që të ka rrjepur gjithë jetën? Nuk e deshe shpëtimin nëpër dorë të atyre që derdhën gjakun për të na siguruar tokë, shtëpi e bagëti të gjithëve!

SELIMI — Mjaft, Laje!

LAJA — Jo, koka jote duhet zbrujtur mirë.

SELIMI — Ti po më bën të çmendem!

LAJA — Pa më thuaj pse duhet ta ruaje ti kullën e barit nesër mbrëma. Fundi i fundit kamionat mund të vinin edhe pa qenë ti aty.

SELIMI — Më thanë të kisha kujdes mos të vinin të arratisurit e ta digjin kullën.

LAJA — E pse ta digjin?

SELIMI — Që mos ta merrte ushtria barin. Kështu më thanë.

LAJA — Kurse Beqir aga donte t'ia jepte patjetër ushtrisë barin se iu dogj zemra Beqirit për ushtrinë tonë. Bile kamionat që do ta merrnin barin do t'ia dërgonin ushtrisë, apo jo? Pse më shikon ashtu si hu. As këtë nuk e kuptove?

SELIMI — Jo, nuk e kuptova.

LAJA — Po nuk e pyete ndonjëherë veten pse ta fal Beqir aga kullën e barit?

SELIMI — Nuk e pyeta. Më pëlqente të gjeja shkaqe që të mos më fusnin në dyshime.

LAJA — E pse kështu?

SELIMI — Ma mori mendjen tapia. Nuk mendoja tjetër veç atë. Punët e tyre i merrja ashtu si m'i tho-

shin dhe nuk përpiqesha t'i peshoja me kandarin tim.

LAJA — Tani bindesh që nesër mbrëma është pregatitë vrasja jote?

SELIMI — Jam turbulluar fare. E shoh se kjo kokë ka nevojë t'i prekë gjërat me dorë.

LAJA — Ja çelësat! Nesër mbrëma do të shkosh të ruash kullën e barit. Vete dot?

SELIMI — Të shkoj the? Ku ta marr atë fat! Po ti... po më beson?

LAJA — Si jo! Harrove se ti je i yni?



## Tabloja e katërt

*Dekori i tablosë së dytë. Zeneli dhe Budja hyjnë në skenë. Të dy janë të lodhur, po Zeneli duket i rënë shpirtërisht.*

ZENELI — *(Ofshan.)* O perëndi, kur do të marrë fund kjo lojë!

BUDJA — Kaq shpejt u mërzite? Ne posa filluam.

ZENELI — E ndiej veten të këputur.

BUDJA — Më duket se frika të ka mbërthyer keq. Ajo t'i këput këmbët. Mirë po tani nuk kemi kohë për frikë. Çfarë u fillua dëhet çuar deri në fund. Ja, unë grua mbajta më shumë nga ti. Veç kësaj i stivova nën kaçekët e misrit dhe i mbulove ashtu që asnjëriut nuk i shkon mendja. Si të kryhen punët vijnë djemtë nga Shkodra dhe i tërheqin andej me karrocë. Laja pastaj le ta marrë kullën e barit dhe pallatin kur të dojë. Se mos do t'i gëzojë gjithnjë! *(Pauzë)* Pse po mendohesh?

ZENELI — Më shkon mendja te Laja. Si e dinte ajo sa thasë drithë kishte kulla përmbrenda.

BUDJA — Ta thashë, s'ka pasë kush tjetër të flasë veç shërbëtorit që iku. Ai ishte luga e tyre. Për fat vetëm atë dinte. Prandaj hiqe mendjen prej Lajes se nuk është koha për të tilla dyshime. Lajes ia

hodha për bukuri. Ajo tani, jam e bindur, beson plotësisht te ne.

ZENELI — Mandej... mos bëmë gabim që i luajtëm ato prej vendi.

BUDJA — Tani të ra në mend për një gjë të tillë? Ti vetë plase derisa i luajte. Apo të prisnim t'i luante Beqir aga me Halil Nuren. Më mirë vendin e tyre ta dimë unë e ti. Pastaj gropa e hapur nën man mos harro se pret Halil Nuren. Ajo gropë na fali flori e kërkon pleh. Halili në gropë nuk di të tregojë asgjë. Kështu as komunistët nuk e marrin vesh ku i pushojnë eshtrat Halil Nures. Sa për Beqir agën ai tashmë i ka orët e numëruara.

ZENELI — Po do të vijë Beqiri?

BUDJA — Patjetër. Më tha Halili. Nuk rri dot pa ardhë. Mosbesimi e shpie deri në marrëzi.

ZENELI — Po sikur të na pyesin komunistët pse e vratë Beqirin?

BUDJA — Budalla! E vramë se desh të na vriste. E kuptoi kurthin që i kishim ngritur dhe na sulmoi.

ZENELI — Prapë nuk më ndjen zemra mirë. Pastaj be-tohem se tek po nxirrnim ato nga dheu kam dë-gjuar zhurmë në kopshtin e zarzavateve.

BUDJA — Shiko se të tilla fjalë na hanë kokën.

ZENELI — Kisha bindje se na ndiqte një hije. E them copë, e kam frikë Lajen. Aq sa e urrej, aq e kam marrë edhe frikë. Kurrë në jetën time nuk kam pasë njeri më frikë se atë. Besoje, e shikoj edhe në ëndërr.

BUDJA — Më duket se do të na marrësh në qafë sonte. Atëherë më mirë të vemi që tani te Laja e t'i themi: «Ne, o Laje, nuk u treguam krejt të pastër me ty. Vërtet të treguam drithin, të treguam mallin brenda në bodrum, po këtë e bëmë që të fshihnim



arin. Ja, merreni edhe arin. Janë tetë teneqe plot me napolona flori. Na ka dalë shpirti mua dhe Zenelit duke i mbartur. Janë jo më pak por pesëdhjetë e pesë mijë napolona flori».

ZENELI — Jo, atë nuk do ta bëjmë kurrë.

BUDJA — «Merrini se i duhen qeverisë së komunistëve që të forcohet dhe të na marrë shpirtin edhe më tepër, pasi Zenelit i duket pak kjo që keni bërë deri tani».

ZENELI — Jo, jo, ai flori tani na përket neve.

BUDJA — Kështu vërtetë e humbim edhe floririn po kokën e sigurojmë dhe ty të largohet ajo frikë që të ka mbërthyer.

ZENELI — Bude, mos fol ashtu.

BUDJA — E pra, atëherë erdhi koha e Halilit. Gropa nën man po pret me gojë të hapur. Po të rrijë shumë ashtu është rrezik të na gëlltisë neve. Halili nuk vete me këmbët e veta të hyjë brenda. Ja, merre këtë. (*I jep një çekan*) Bjeri kokës dhe trullose. Duhet t'i biesh fort, ndryshe bërtet. Një go-ditje e mirë kushton tetë teneqe flori.

ZENELI — Ta marrë djalli, nuk kam vrarë kurrë njeri.

BUDJA — Mendo pesëdhjetë e pesë mijë napolonat e shiko sa e lehtë do të të duket kjo punë. Fundi i fundit një pleh po heq nga shtëpia. Hajt, nišu. (*Hyn Beqir aga.*) Ja edhe Beqir aga! Të thashë se do të vinte?

BEQIRI — U gëzove?

BUDJA — Si jo! Kur të kemi ty pranë punët venë edhe më mirë.

BEQIRI — Mirëmbërëma!

BUDJA — Mirë se na erdhe! Urdhëro! Kur e kishe ndër mend të vije, zoti Beqir, pse u vonove kaq?!

BEQIRI — Tani neve na ngeli vetëm nata! (*Shikon*

- orën.) Besoj se kam ardhë në kohë. (*Zenelit.*) Po ti pse ma mban atë çekan në dorë?
- BUDJA — Gozhdët i ke mbi sergjen. Forcoja mirë rezen derës. Shko se po rri unë me Beqir agën.
- ZENELI — Pra të shkoj, Beqir aga?
- BEQIRI — Shko, po mos u vono. Dasma mund të fillojë nga çasti në çast. (*Zeneli del.*)
- BUDJA — Të pa njeri kur erdhe?
- BEQIRI — As qen nuk dëgjova të lehë. Edhe ata i ka marrë frika.
- BUDJA — Karrocën ç'e bëre?
- BEQIRI — Pret në plepishtë. Si duken punët këndej?
- BUDJA — Çdo gjë vete si sahat.
- BEQIRI — Ç'bëhet Selim Myrtja?
- BUDJA — Ruan kullën e barit.
- BEQIRI — E ruan mirë?
- BUDJA — Si mallin e vet.
- BEQIRI — Qerosi i dërrit. Dësh të bëhet zotni.
- BUDJA — Ja pra edhe atij malli po ia ha kokën. Kështu e ka kjo botë, Beqir aga. Malli ha kokën e koka ha mallin.
- BEQIRI — Paske qejf për shaka sonte.
- BUDJA — Më pëlqen të flas kur e shoh se punët shkojnë mirë.
- BEQIRI — Ku është Halili?
- BUDJA — Po rri me pushkë për faqe, ashtu siç e ke urdhëruar. Po pret sa t'i dalë flaka kullës së barit. Laja e Mani do të na bëhen kurban sonte. Edhe ata u ngopën me ne. Lanë lesh sa mundën. Pse më shikon ashtu, Beqir aga, mos po të vjen keq për ta?
- BEQIRI — Keq të vjen ty. Ti nuk e doje kurbanin e tyre.
- BUDJA — Epo unë nuk i mendoj punët aq thellë sa



ti, Beqir aga. Sa mirë je kujtuar ta lësh karrocën në plepishtë. Do të shikosh kullën në flakë. Do të marrësh vesh vrasjen e Lajes dhe të Manit e do të ikësh pa e marrë vesh njeri se ishe këtu. Atëherë komunistët nuk kanë ndonjë arsye të dyshojne te ti. Po një gjë nuk më ka pëlqyer, të them të drejtën. Pse e vendose vrasjen e tyre tinës meje dhe Zenelit.

BEQIRI — Bude, nuk është koha për dyshime të tilla.

BUDJA — Ndoshta bëra gabim që pyeta.

BEQIRI — Sot a kurrë ia kemi nevojën njëri-tjetrit. E di se luhet me kokë? Mendo se në këtë lojë kokash hyjnë kokat tuaja dhe koka ime. E, po të shkojë koka ime njësoj si koka e Selim qerosit, ky është fundi i botës. Ti e di sa miliona kam varrosë në këtë vend. Ato janë në rrezik kështu si koka ime. U ngrit rajaja e tokave, u ngritën fundërrinat e qytetit dhe kërkojnë pasurinë time. Kjo të bën të hash veten me dhëmbë. Unë, po të mundja ua hiqja edhe ato lecka që kanë veshë. Ua rripja edhe lëkurën.

BUDJA — Shfre, shfre, Beqir aga, se të bën mirë.

BEQIRI — Mirë bëhem unë atëherë kur të zhduket kjo farë e tyre. (*Dëgjohet një ofshamë e largët, e thellë.*) Po kjo?

BUDJA — Çfarë!

BEQIRI — Nuk dëgjove ti?

BUDJA — Jo! Çfarë ishte?

BEQIRI — Si një hungrimë që del nga dheu.

BUDJA — Ah po, do të jetë bushtra jonë. Kështu hungron kur e lidhin. Sigurisht do ta ketë lidhë Zeneli.

BEQIRI — Edhe ai gjeti kohën të lidhë qentë. (*Dëgjohet përsëri*) Jo, kjo nuk është hungrimë qeni! Diçka po ndodh atje poshtë.

- BUDJA — Eja në vete, Beqir aga. Të ushtojnë veshët nga shqetësimi. Ajo është hungrima e bushtërës sonë. E dëgjova mirë.
- BEQIRI — Ndoshta! (*Këndojnë gjelat në fshat.*)
- BUDJA — Po këndojnë gjelat. Sa shkoi ora?
- BEQIRI — Tamam mesnatë. (*Shkujnë te dritarja.*)
- BUDJA — Natë e kthjellët, qetësi para furtune.
- BEQIRI — Hë pra, kur do të fillojë kjo drej furtune!
- BUDJA — Do të fillojë, Beqir aga, do të fillojë, mos ki frikë. Sa bukur ndrin hëna sonte.
- BEQIRI — Ta marrë djalli, kjo natë nuk duhet të kish-te hënë! (*Dëgjohen të shtëna.*) Filloi.
- BUDJA — Po, pikrisht në mesnatë. Sa të përpikët i ka Halili shokët!
- BEQIRI — Besoj se Selim Myrtja e mori tapinë siç e kërkoi.
- BUDJA — Patjetër.
- BEQIRI — Po kulla ende nuk po nxjerr tym.
- BUDJA — Prit, zotni Beqir, e do edhe ca punë për t'i dalë tymi. (*Bien shumë pushkë e duket luftë e vërtetë.*)
- BEQIRI — Po kjo?
- BUDJA — Po ja, ndryshe nuk i del tymi kullës.
- BEQIRI — Çfarë tymi moj, këtu po luftohet. Këta janë partizanë!
- BUDJA — Je në vete! Çfarë duan partizanët këndej? Këta janë trimat e Halil Nures.
- BEQIRI — Pse, kaç pushkë u dashkan për të qeruar një qeros si Selim Myrtja? (*Lufta egërsohet edhe më tepër. Dëgjohen të thirrura.*) Bude, çfarë po ndodh kështu?
- BUDJA — Çdo gjë vete si sahat.
- BEQIRI — (*Vete te dritarja*) Çfarë sahati, moj? Këtu është ngritur i gjithë fshati në këmbë.



BUDJA — Të bëjnë sytë, Beqir aga.

BEQIRI — Ja, ja, shikoji atje larg.

*(Hyn Zeneli i shprishur flokësh)*

BUDJA — Ç'u bëre, o i zi!

BEQIRI — Po ti?

ZENELI — Si, akoma ti këtu?

BEQIRI — Çfarë ke bërë kështu?

BUDJA — E vrave?

ZENELI — Unë timin e qërova po ti çfarë pret!

BUDJA — Ty po të prisja, ta marrë djalli! *(Do të nxjerrë revolen por ia beh menjëherë Mani me dy të rinj.)*

MANI — Mos luani! *(Budes)* Ule armën!

BUDJA — Ta vras, o Man!

MANI — Ule se të vrava! *(Një i ri e çarmatos.)*

ZENELI — Tani e mori lumi! *(Budes lehtë)* Ç'na bëre o Bude!

BUDJA — Pse s'më lini ta vras atë derr.

MANI — Nuk është nevoja ta vrasësh ti. *(Të rinjtë i venë hekurat Beqirit.)* Paske qenë me fat, o Beqir. Po të të takonte Selim Myrtja para nesh do të t'i ftohte morrat. Ta kishte bërë benë. S'e vrave dot Selim Myrton, o Beqir aga. As kullën e barit nuk e dogjë. Edhe miqtë e tu e paguan me lekurë. Kërmë i ke nëpër plisa dhe gardhije.

BUDJA — Selimin e shpëtuan ne. Unë i tregova Lajes se ai do të vritej te kulla e barit.

BEQIRI — E pse e bëre këtë, o Bude?

BUDJA — Pse ashtu e meritoje ti.

BEQIRI — E di si e meritoni ju, po tani është vonë.

MANI — Po flet me vete, Beqir aga? Pse shikon ashtu si i çmendur.

BEQIRI — Po shikoj fundin.

MANI — E si po të duket?

BEQIRI — Si vdekja. Bile vdekja është më e ëmbël se ky fund që shikoj.

(*Hyn Laja*)

BUDJA — Laja! Sa mirë që erdhe!

LAJA — Oho! Mirëmbërëma, Beqir aga! Nuk po më përgjigjesh? Të pata thënë të kujtosh Xhemalin e Sulën. Të bie ndër mend?

BEQIRI — Më bie ndër mend.

LAJA — E pse i vrave? Nuk përgjigjesh? Do të përgjigjesh për të gjitha atje ku është vendi. Hiqeni kënde! (*E marrin dy nga fshatarët që kanë ardhë me Lajen*).

BUDJA — Hë më të lumtë! Mirë ia bëre. Më thanë se u vranë të arratisurit.

LAJA — Ata na morën të keqen, po Halil Nuren nuk e gjetëm as e takuam kund.

ZENELI — Kërkuat në gropën e bodrumit?

MANI — Kërkova unë. Atje nuk kishte njeri.

ZENELI — Atëherë paska ikë.

BUDJA — Tani do të vij t'ju tregoj derën nga hyhet në bodrum të kullës. Do të çuditeni kur të shikoni ç'mall është aty brenda. Ky ishte kësti më i madh që ju premtova.

LAJA — Prapë pak.

BUDJA — Nuk po të kuptoj.

LAJA — Beqir aga kushtonte më tepër. Këstin e madh më duket se harrove ta paguash.

BUDJA — Çfarë kësti, Laje?

LAJA — Ne vamë në gropën e bodrumit të gjenim Halil Nuren, po gjetëm vetëm gjurma gjaku. Ato gjurmë na drejtuan deri... te gropa nën man. (*Me autoritet*.) Pse e vratë Halil Nuren?

BUDJA — Kush, unë?

LAJA — Ti o Zeneli nuk ka rëndësi.



BUDJA — E vramë se desh të vrasë ty dhe Manin.

LAJA — Ashtu? (*Hyn Lulja. Ka një tufë lule shege në dorë.*) Po ti, o Lule, ku ishe?

LULJA — Atje ku më çove ti, në kopshtin e zarzava-teve.

LAJA — E çfarë bëje atje?

LULJA — Ruaja Zenel Danin dhe Buden.

BUDJA — Qyqja, po neve pse?

LULJA — Që t'ju shikoja duke nxjerr teneqetë me florinjt nga gropa nën man. I futët nën kaçekët e misrit plot tetë teneqe flori. E hapi njerën komisari. Flori dynjaja! Të gjithë napolona të verdhë.

ZENELI — Fundi, fundi, xhehnemi!

BUDJA — Mbaje veten, o i zi, e mos i bëj ata të gëzohen me frikën tënde. Ne nuk mbarojmë aq lehtë. Edhe po të mos jemi ne, të tjerë do të na marrin hakun. Paratë që na i grabitën do t'u dalin për hundësh.

LAJA — Së fundi u detyrove t'i nxjerrësh kthetrat. Tani je Budja e vërtetë.

BUDJA — Këto kthetra duheshin nxjerrë me kohë.

LAJA — Kurdo që t'i nxirrnit gërshërët i kishim në dorë.

BUDJA — Na mundët.

LAJA — Patjetër që ju mundëm. Tani e kuptove këtë?

Ju mundi populli, që ju s'e keni përfillur kurrë. Kjo është koha jonë, o Bude, koha e Partisë. Die-lli i saj djeg e përvëlton farën tuaj kurse neve na ndrin rrugën përpara. Shko, Bude, shko te miqtë e tu e na liro rrugën. I nisni edhe këta atje ku e kanë vendin. (Mani me dy fshatarë i përcjellin. Laja i sillet Lules.) Po Selimi ku është?

Nuk ma zuri syri.

LULJA — Atij tani i vjen turp prej teje.

LAJA — Ku e takove?

LULJA — Kishte vajtë atje te murana e Xhemalit dhe po qante. Desha ta sjellë këtu por nuk pranoi kurrësesi. Ishte shumë i tronditur.

LAJA — S'ka gjë, i bën mirë.

LULJA — Atëherë unë këputa ca lule shege. Ky m'u duk peshqeshi më i mirë për ty sonte. *(I jep lulet dhe e përqafton.)*

LAJA — Të falem nderit, Lule. Sonte bëmë një punë të mirë për pushtetin tonë të ri.

LULJA — Sikur të ishin edhe Xhemali me Sulën.

LAJA — Ata i kujtova shumë sonte. Sa bukur kanë çelë këto lule!

LULJA — Edhe mua më pëlqejnë shumë.

LAJA — Sula thoshte se janë lulet e revolucionit!  
(Jashtë dëgjohen thirrje gëzimi. Laja me Lulen dalin në çardak e përshëndesin turmën.)

## FUND